



PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL  
**RAPORTI I  
VLERËSIMIT TË  
ZBATIMIT**

PROGRAMI I MBËSHTETJES SË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR KOMUNAL NË KOSOVË



Implementuar nga:  
**UN HABITAT**  
FOR A BETTER URBAN FUTURE

Financuar nga:  
**SWEDISH DEVELOPMENT  
COOPERATION**



Shembulli i Komunes së Junikut

PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË ZBATIMIT

Tetor 2014

PROGRAMI I MBËSHTETJES SË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR KOMUNAL NË KOSOVË



KOMUNA E  
JUNIKUT

Implementuar nga:

**UN HABITAT**  
FOR A BETTER URBAN FUTURE

Financuar nga:

**SWEDISH DEVELOPMENT  
COOPERATION**



Ky raport është hartuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Kadaster dhe Mjedis me drejtoritë tjera brenda Komunës së Junikut dhe me Programin për Mbështjetjen e Komunave në Planifikim Hapësinor (PMKPH) të UN-Habitat-it, program ky i financuar nga Qeveria e Suedisë. Stafi profesional i komunës i përfshirë në hartimin e raportit janë: Ferdone Tofaj, Xhavit Jasiqi, Flurije Shehu, Xhemë Shehu, Avdyl Maloku, Hysen Imeri. Përkrahje profesionale nga PMKPH/UN-Habitat është dhënë nga: Teuta Jaha, Arnet Haskuka, Gloriosa Hisari dhe Drita Nushi.

Raporti është dokument intern i komunës i cili do të shërbejë për punë të mëtutjeshme gjatë hartimit të hartës zonale. Përderisa përmbajtja e tij nuk i reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e UN-Habitat-it apo Qeverisë së Suedisë

## PËRMBAJTJA

I.	AKRONIMET .....	3
II.	HYRJE .....	4
2.1	HYRJE.....	4
2.2	QËLLIMI I RAPORTIT MBI VLERËSIMIN E ZBATIMIT TË PZHK PËR PERIUDHËN 2011-2013.....	4
2.3	PROCESI DHE METODOLOGJIA E PUNËS.....	5
2.4	KORNIZA E VLERËSIMIT TË ZBATIMIT TË PLANIT .....	5
III.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E PËRMBAJTJES SË PZHK .....	7
IV.	ANALIZA DHE REZULTATET E VLERËSIMIT TË ZBATIMIT TË PLANIT PËR VITET 2011-2013	9
V.	KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET.....	15
VI.	SHTOJCA.....	18
6.1	ZBATIMIT I PROJEKTEVE SIPAS ZONAVE NË HAPËSIRË.....	18
6.1.1	ZONA 1 .....	18
	<b>BJESHKA - ZHVILLIMI I TURIZMIT SI REZULTAT I POTENCIALEVE TË TRASHËGIMISE NATYRORE .....</b>	<b>18</b>
6.1.2	ZONA 2 .....	23
6.1.3	ZONA 3 .....	29
6.1.4	ZONA 4 .....	33

Tabela 6.1. VLERESIM I ZBATIMIT TE AKTIVITETEVE/VEPRIMEVE TE PZHK JUNIK PER PERIUDHEN 2011-2013.. 37

### LISTA E TABELAVE

Tabela 2.4.1. Tabelës për vlerësimin e veprimeve.....	6
Tabela 2.4. 2: Fushat tematike për vlerësimin e arritjes së synimeve të planit.....	7

### LISTA E HARTAVE

Harta 4.1 Implementimi në Zonen Urbane .....	12
Harta 4.2 Implementimi në territorin e Kumunës së Junikut.....	13
Harta 4.3 Implementimi i PZHK-së gjate viteve 2011-2013 dhe efektet.....	14

# I. AKRONIMET

PZHU	Plani Zhvillimor Urban
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
PMKPH	Programi për Mbështjetjen e Komunave në Planifikim Hapësinor
NGOs	Organizatat Joqeveritare
VSM	Vlerësimi Strategjik I Mjedisit
Sida	Swedish International Development Cooperation Agency
UN-Habitat	United Nations Human Settlements Programme

## II. HYRJE

### 2.1 HYRJE

Në bazë të Ligjit nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor është përgjegjës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale të Komunës .

Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) është plan me karakter strategjik multisektoral I cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe hapësinor të komunës dhe përfshin periudhën së paku 8 vjeçare. PZHK hartohet për gjithë territorin e komunës (pra përfshin edhe zonat urbane dhe fshatrat brenda komunës). PZHK duhet të jetë në përputhshmëri me Planin Hapësinor të Kosovës. PZHK poashtu duhet të përfshijë ndikimet shoqërore, ekonomike dhe mjedisore që dalin nga zbatimi i aktiviteteve të tij. Plani Zhvillimor Urban (PZHU) është plan strategjik multisektoral I cili përcakton synimet afatgjata për zhvillim dhe menaxhim të zonave urbane në periudhën prej së paku 8 viteve. PZHU duhet të përcaktojë zhvillim të ekuilibruar dhe qëndrueshëm të zhvillimit hapësinor të zonave urbane dhe duhet të bazohet në qeverisjen e mirë dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, social, ekologjik dhe kulturor.

Komuna e Junikut e ka PZHK-ne dhe PZHU-ne te miratuar me daten 29.07.2011 ne baze te Ligjit nr.2003/14 por megjithate keto plane mbeten ende ne fuqi derisa te harmonizohen me Ligjin e ri nr.04/L-174 per Planifikimin Hapesinor. Sipas Ligjit te ri per Planifikimin Hapesinor, obligim i Komunes është të përgatitë Raportin e monitorimit te zbatimit te qellimeve dhe objektivave te deklaruar ne PZHK, (Nenin 10, paragrafi 3 i LPH-se si dhe Neni 4, paragrafi 4.4 i UA nr.05/2014 per Pergjegjesite e Autoriteteve te Planifikimit Hapesinor si dhe Parimet dhe Procedurat per Pjesemarrjen e Publikut ne Planifikim Hapesinor). Ndersa, sipas dispozitave të parapara me plan, planet rishikohen/revidoohen në tërësi pas pesë viteve.

Gjate analizave eshte verejtur se nje pjese e madhe e projekteve eshte zbatuar ndersa nje pjese tjeter eshte ne zbatim e siper. Duke u bazuar ne kete fakt mund te konkludojme qe zhvillimet ne Komunen e Junikut jane bazuar ne PZHK dhe plani qe eshte ne fuqi nuk ka nevojë per revidim. Per permbushje te obligimeve ligjore rekomandohet qe ne te ardhmen te hartohet Harta Zonale e Komunes.

### 2.2 QËLLIMI I RAPORTIT MBI VLERËSIMIN E ZBATIMIT TË PZHK PËR PERIUDHËN 2011-2013

Qëllimi kryesor i këtij raporti është të jap një pasqyrë për shkallën e zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal për periudhën kohore tri vjeçare (2011-2013) dhe të ofrojë rekomandimet e duhura të cilat janë të nevojshme gjatë procesit të hartimit të hartës zonale/harmonizimi i PZHK me Ligjin e ri per Planifikim Hapesinor. Përmes tij, do të jipet një reflektim lidhur me zhvillimin e komunës pas realizimit të aktiviteteve të planifikuara, gjendjen aktuale në hapësirë si dhe të efekteteve të arritura. Raporti ofron poashtu edhe teknikat/veçat dhe metodologjinë të cilat janë zhvilluar për vlerësimin e planit, e të cilat mund të shfrytëzohen si mjete pune për ndërtimin e një sistemi të monitorimit dhe vlerësimit kontinual. Analiza e bërë së bashku me rezultatet e dhëna në raport janë pikënisje për hartimit të hartës zonale/ harmonizimi i PZHK me Ligjin e ri per Planifikim Hapesinor.

Domosdoshmëria e hartimit të raportit të këtillë vie si kërkesë ligjore, Neni 10, paragrafi 3 i LPH-se si dhe Neni 4, paragrafi 4.4 i UA nr.05/2014 për Përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinor.

### **2.3 PROCESI DHE METODOLOGJIA E PUNËS**

Raporti është hartuar nga ekipi punues në përbërje nga stafi i drejtorateve sektoriale të komunes dhe me përkrahjen profesionale nga Programi për Mbështetjen e Komunave në Planifikim Hapësinor i UN-Habitat-it.

Për të realizuar këtë vlerësim, ekipet punuese në plan kanë zhvilluar mjete dhe metodologji pune të cilat mund t'i shërbejnë komunës edhe në të ardhmen.

Mjetet e zhvilluara gjatë këtij procesi janë bazuar në llojin dhe strukturën e PZHK së Junikut dhe janë të aplikueshme për planet e hartuara kësilloj. Ato përfshijnë:

- kornizën për vlerësimin e zbatimit të aktiviteteve të propozuara me plan; dhe
- vlerësimin e efekteve që kanë rezultuar nga zbatimi i atyre projekteve

Metodat e aplikuara në përpilimin e Raportit monitorues i zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të deklaruara në Planin Zhvillimor Komunal janë të llojllojshme duke përfshirë punë individuale, punë grupore përmes punëtorive të ndryshme që janë mbajtur, takime konsultimi me akterë relevant nga të cilët janë siguruar informacione të rëndësishme mbi zbatimin e planit etj.

Mjetet dhe metodat e punës të përdorura nga grupi punues gjatë vlerësimit do të shërbejnë dhe në të ardhmen gjatë vlerësimit dhe monitorimit të PZHK dhe implementimit të hartës Zonale të komunës.

Për të përmbushur obligimet ligjore komuna është e obliguar që çdo vjetë të hartojë Raportin monitorues të zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të deklaruara në Planin Zhvillimor Komunal.

### **2.4 KORNIZA E VLERËSIMIT TË ZBATIMIT TË PLANIT**

Vlerësimi i zbatimit të PZHK bazohet në të arriturat zhvillimore të komunës. Procedura e vlerësimit paraqet një mjet për konfirmimin e arritjeve përballë aktiviteteve të planifikuara dhe rezultateve të pritura. Kjo përgjigje nuk është e drejtpërdrejtë meqenëse zbatimi i planeve është një proces i ndërlikuar që lidhet me një sërë veprimesh të ndërvarura.

- Në PZHK e Junikut janë përfshirë një sërë strategji dhe veprime për arritjen e synimeve dhe objektivave për çdo fushë tematike. Veprimet dhe programet janë të definuara në aspektin e kohëzgjatjes kohore, implikimeve financiare dhe kornizës institucionale për implementimin e tyre dhe të lidhura me kornizën afatmesme të buxhetit 2011-2013 (Tabela 1).

Është bërë identifikimi i veprimeve që nuk janë realizuar dhe ato që duhet të përfshihen në planet e ardhshme dhe

- zbatimi i aktiviteteve/projekteve të propozuara ka shërbyer për vlerësimin e efekteve në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, social dhe hapësinor të komunës. Vlerësimi është bërë për çdo fushë tematike (Tabela 2), dhe në bazë të vlerësimit vetanak nga ana e zyrtarëve komunal lidhur me të arriturat e tyre.

Tabela 2.4.1. Tabelës për vlerësimin e veprimeve

FUSHA	KODI I PROJEKTI T	VEPRIMET/ PROJEKTE T/PROGRAMET	INSTITUCIONI PERGJEGJES	SUBJEK TET TJERA TË PËRFSHIRA	PRIORITET	KOHEZGJATJA	VLERA FINANCIARE	TREGUESIT PER VLERESIM (Indikator)	A është ZBATUAR	A duhet të përfshihet në planin e reviduar	VEREJTJE/KOMENTET	
A-ZHVILLIM SOCIAL DHE INFRASTRUKTURA SOCIALE , B-ZHVILLIM I EKONOMIK , C- INFRASTRUKTURA TEKNIKE, TRANSPORTI DHE SHËRBIMET PUBLIKE , D - VENDBANIMET DHE BANIMI, E- MJEDISI, RESURSET NATYRORE DHE ZONAT E RREZIKUARA NGA DEGRADIMI DHE FAKEOESITË .F- TRASHËGIMIA KULTURORE , SHFRYTËZIMI I TOKËS, G-NGRITJA E KAPACITETEVE NE PLANIFIKIM HAPËSINOR,												
	V1											
	V2											
	V3											
	V1											
	V2											
	V3											
	V1											
	V2											
	V3											
	V1											
	V2											
	V3											
	V1											
	V2											
	V3											

Burimi: Komuna e Junikut, PZHK e Junikut 2011-2023



Tabela 2.4. 2: Fushat tematike për vlerësimin e arritjes së synimeve të planit

A	ZHVILLIMI SOCIAL DHE INFRASTRUKTURA SOCIALE
B	ZHVILLIMI EKONOMIK
C	INFRASTRUKTURA FIZIKE, TRANSPORTI DHE SHËRBIMET PUBLIKE
D	SHFRYTËZIMI I TOKËS, VENDBANIMET DHE BANIMI
E	MJEDISI, RESURSET NATYRORE DHE ZONAT E RREZIKUARA NGA NDOTJA, DEGRADIMI DHE FATKEQËSITË
F	TRASHËGIMIA KULTURORE
G	KAPACITETET NJERËZORE DHE ORGANIZATIVE NË FUSHËN E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Burimi: MuSPP3, UN-Habitat, 2014

### III. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E PËRMBAJTJES SË PZH K

Junku si një komunë e re sipas konceptit të zgjedhur për zhvillim, ndahet në katër zona. Zonat 1 dhe 2 janë zonat ku është më së shumti i shprehur potenciali i trashëgimisë natyrore Bjeshkët (1) dhe pyjet (2). Mirëpo pas aprovimit të Bjeshkëve të Nemuna si Park Nacional zona 1 dhe 2 mbesin nën kompetencën të nivelit qendror (Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Mjedisi). Zona 3 paraqet zonën ku është i koncentruar banimi në tri vendbanimet - qytezën e Junikut dhe dy fshatrat Jasiq dhe Gjocaj. Në kuadër të kësaj zone kemi edhe koncentrimin e zhvillimit të aktiviteteve ekonomike si dhe potencialet e trashëgimisë kulturore. Kurse zona 4 është karakteristike për potencialin për zhvillim të bujqësisë.

ZONA 1 - Bjeshka - Kjo zonë përfshin një sipërfaqe të madhe (rreth 4.000 Ha) dhe shtrihet në lartësi mbidetare mbi 2500 m. Është zonë e kryesisht e zhveshur ndaj edhe nuk ka mundësi për kultivimin e kulturave vegjetative. Ajo që e bën karakteristike këtë zonë është pika më e lartë Gjeravica me një lartësi mbidetare 2656 m. Duke marrë parasysh këto karakteristika, kjo zonë mund të shfrytëzohet për kullosën dhe zhvillimin e turizmit malor (sidomos alpinizmit).

Sipërfaqet e mëdha me pyje, livadhe e kullosën paraqesin faktorë favorizues të zhvillimit të blegtorisë përcjellur me mundësinë e zhvillimit të industrisë ushqimore. Juniku ka pasur traditë në zhvillimin e sektorit të blegtorisë ndaj dhe kjo traditë duhet të fuqizohet edhe më tutje. Në anën tjetër, edhe pse ajo po zhvillohet në masë të vogël sidomos pas luftës, bujqësia mbetet një sektor i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik nëse rritet interesimi për kultivimin e kulturave intensive dhe industriale sidomos kultivimi në sera dhe krahas kësaj fuqizimi i sektorit privat për t'i kushtuar rëndësi më të madhe zhvillimit të agro-biznesit Turizmi i bazuar në natyrë dhe ai kulturor është i dukshëm dhe paraqitet si një ndër potencialet më të fuqishme për zhvillim ekonomik, por, që vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet edhe zhvillimit të infrastrukturës turistike dhe të sektorëve tjerë përcjellës të tij si: hotelerisë, artizanateve, kulturës, sportit e rekreacionit etj. Pasuritë ujore, sidomos lumi Erenik paraqet një potencial të madh në të ardhmen në zhvillimin e sektorit të energjisë së ripërtërishme/alternative.

Sipas planit pengesë është qasja deri në Bjeshkë e cila është e vështirë, mungesa e infrastrukturës së nevojshme për shfrytëzim racional qoftë për nevojat e vendësve ose atyre për vizita turistike. Pra ofrimi i kushteve më të mira për

lëvizshmërinë e banorëve (shtigjet e këmbësorëve, trotualet, sinjalizimet etj) por edhe turistëve janë poashtu një sfidë e veçantë për tu ballafaquar. Meqë turizmi shihet si një potencial i ardhshëm për zhvillim, një rëndësi e vecantë duhet t'i kushtohet edhe infrastrukturës përcjellëse që e ndihmon zhvillimin e këtij sektori (rregullimi i vijave të ecjes deri në zonat turistike, vendkampingjet, etj).

ZONA 2 - Zona e pyjeve përfshin një territor përafërsisht prej 3400 Ha. Në kuadër të kësaj zone ndodhen dy fshatrat Jasiq dhe Gjocaj që aktualisht janë gati të depopulluara. Për shkak të karakteristikave morfologjike, kjo zonë shfrytëzohet për zhvillimin e aktiviteteve blegtorale, pemëtarisë, bujqësisë dhe poashtu paraqet potencial për zhvillimin e turizmit e sidomos atij rural.

ZONA 3 – Vendbanimet - Në baze të analizave të bëra në PZHK, deri në 2023 pritet që në Junik të ketë rreth 6600 banorë (pra pa diasporën), respektivisht rreth 8 700 banorë me diasporën (llogaritur me të dhënat nga anketimi për PZHK-në). Ky Plan për periudhën që hartohet nuk propozon zgjerim të zonës urbane, pra zona urbane mbetet në kufijtë e përcaktuar me PZHU. Ndërtimet në kuadër të zonës ekzistuese urbane - ku ka mundësi dendësimi në hapësirat dhe në Zonën e Re në vendbanimet Jasiq dhe Gjocaj - e cila mund të akomodojë një pjesë të konsiderueshme të njëjësive të banimit. Zona të reja të ndërtimeve në funksion të zhvillimit të turizmit dhe rekrejimit

Kjo do të thotë se zonat e vendbanimit në 15 vitet e ardhshme duhet të pranojnë edhe rreth 1200 banorë rezident, respektivisht 3270 banorë përfshirë diasporën. Sa përket institucioneve parashkollore Juniku ka nevojë për një çerdhe të fëmijëve. Ndersa, duke u bazuar në standardet për shkolla fillore, në Junik (për popullsinë e parashikuar) nuk ka nevojë për shkolla të reja fillore e as për ato të mesme. Rekomandohet krijimi i kushteve për shkolla profesionale në fushën e turizmit, artizanateve, gastronomisë, agrikulturës, energjisë alternative etj.

Juniku është Komunë e re dhe ende në konsolidim e sipër dhe ka nevojë për ngritjen e objekteve që adresojnë çështjet sociale përfshirë edhe ato për punësim.

Fusha e zhvillimit ekonomik në të gjitha sferat e në veçanti në turizëm dhe veprimtaritë përcjellëse të kësaj fushe, bujqësi përfshirë blegtorinë, pylltari dhe energji alternative si potenciale për zhvillim, është parë si prioriteti më i lartë për komunën e Junikut. Juniku ka potencial të llojllojshëm për zhvillim të turizmit kulturor dhe atij natyror (rekreativ, kurativ, eko-turizmit, ndërkuftar, turizmit alpin, rural dhe atij konferencial). Zhvillimi i turizmit kulturor lidhet ngushtë me trashëgiminë arkitektonike (prezencën e kullave tradicionale) dhe atë shpirtërore (ruajtja e dokeve, zakoneve, riteve etj). Sa i përket infrastrukturës, fokusi kryesor në PZHK i është dhënë rrugës tranzit, hapjes së re të rrugës lokale “Te Udha e Kuqe” e cila siguron dalje në rrugën regjionale si dhe infrastrukturës rrugore dhe asaj për këmbësorë për qasje në Bjeshkë. Prioriteti i lartë i jepet edhe përmirësimit dhe shtrirjes së shërbimeve publike në gjithë territorin e komunës së Junikut.

ZONA 4 – Bujqësia - Paraqet një veprimtari të rëndësishme dhe potencial zhvillimor në Junik por fatkeqësisht shënon kultivim të ulët të rendimenteve bujqësore. Konkurrenca joreale në treg, qasja e vështirë në tokat bujqësore, mosorganizimi i fermerëve, kreditë jo të favorshme, kapacitete të pamjaftueshme njerëzore në komunë në këtë fushë, mosinteresimi i të rinjve për t'u marrë me këtë profesion etj., janë disa arsye të ngecjes së zhvillimit të bujqësisë. Koncepti

i zhvillimit të ardhshëm hapësinor i komunës, e vendos mbrojtjen e tokës bujqësore dhe zhvillimin e bujqësisë si prioritet të larta të zhvillimit të ardhshëm. Kultivimi i frutave: Kultivimi, grumbullimi i frutave me theks të veçantë atyre pyjore (gështenjat, boronicat) dhe plasimi i tyre në tregjet e jashtme si dhe bimëve më veti shëruese është një mundësi zhvillimi. Agro-industria: Krahas ruajtjes së këtij resursi, korniza e zhvillimit hapësinor rëndësi i kushton edhe zhvillimit të agroindustrisë në lokacionin e përcaktuar si zonë për prodhimtari në PZHU si dhe tregut të gjelbërt gjithashtu. Fuqizimi i sektorit të bujqësisë në kuadër të komunës, ngritja e kapaciteteve organizative të fermerëve, fushata vetëdijesimi etj., janë disa aspekte tjera zhvillimore të bujqësisë.

Blegtoria: Nga fusha e blegtorisë, bletaria është parë si veprimtari më shpresëdhënëse dhe potencial për zhvillim pasuar me prodhimin e mjaltës. Zhvillimi i kësaj veprimtarie lidhet ngushtë me prodhimtarinë e pemëtarisë.

## **IV. ANALIZA DHE REZULTATET E VLERËSIMIT TË ZBATIMIT TË PLANIT PËR VITET 2011-2013**

Vlerësimi i zbatimit të planit është bërë duke analizuar realizimin e aktiviteteve të parapara me plan dhe efekteve të arritura nga zbatimi i tyre në raport me arritjen e synimeve të planit. Analiza për vlerësimin e zhvillimeve dhe efekteve është bërë për katër zona funksionale të identifikuara me PZHK. Zonat 1 dhe 2 janë zonat ku është më së shumti i shprehur potenciali i trashëgimisë natyrore Bjeshkët (1) dhe Pyjet (2). Zona 3 paraqet zonën ku është i koncentruar banimi në tri venbanimet - qytezën e Junikut dhe dy fshatrat Jasiq dhe Gjocaj. Në kuadër të kësaj zone kemi edhe koncentrimin e zhvillimit të aktiviteteve ekonomike si dhe potencialet e trashëgimisë kulturore. Kurse zona 4 është karakteristike për potencialin për zhvillim të bujqësisë.

*Vizioni i Junikut është: "Juniku, Park etnografik, vend i traditës, që ruan, zhvillon dhe promovon vlerat e tij njerëzore, kulturore, historike dhe natyrore; me arsimim cilësor dhe mirëqenie sociale; me turizëm, bujqësi (agroindustri) dhe infrastrukturë të zhvilluar; mjedis të pastër, të qëndrueshëm dhe të sigurtë për të gjithë".*

Vizioni është pasuruar me një përfshirje të synimeve që kanë një radhitje sipas fushave tematike të: zhvillimit social dhe infrastrukturës sociale, zhvillimit ekonomik, infrastrukturës fizike, transportit dhe shërbimeve publike, shfrytëzimit të tokës, vendbanimeve dhe banimit, mjedisit dhe resurseve natyrore, trashëgimisë kulturore si dhe aspektin e ngritjes së kapaciteteve në planifikim hapësinor. Në kuadër të fushave tematike janë të përfshira një sërë objektivash dhe me këtë raport është vlerësuar zbatueshmëria e objektivave.

Në bazë të vlerësimit të bërë të zbatimit të veprimeve të planit dhe arritjes së synimeve të lartpërmendura, konstatimi i përgjithshëm është se gjatë periudhës 2011-2013 veprimet e PZHK dhe synimet janë zbatuar deri në masë të caktuar dhe ende kemi veprime që janë në zbatim e sipër. Duke u mbështetur në faktin që zhvillimet në Junik janë bërë në bazë të

PZHK në përjashtim të dy veprimeve që janë realizur jashtë PZHK mund të konstatojmë që Juniku nuk ka nevojë të revidojë PZHK por mund të vazhdojë me hartimin e Hartës Zonale duke përfshirë rekomandimet nga ky vlerësim. Në vijim është përshkrimi i vlerësimit sipas fushave tematike:

**A: ZHVILLIMI SOCIAL DHE INFRASTRUKTURA SOCIALE** - Sipas analizave të veprimeve të parapara dhe atyre të realizuara në PZHK është vërejtur se papunësia ende është sfidë në komunën e Junikut. Synimet të lartëpërmendura më shumë i referohen zonës urbane pasi që edhe koncentrimi dhe shtrirja e popullsisë është në këtë zone, ndërsa në zonën pyje në të cilën shtrihen edhe vendbanimet Gjocaj e Jasiq nuk janë shumë të shprehura pasi që edhe ashtu këto fshatra janë të depopulluara.

Ndërsa, sa i përket veprimeve që janë paraparë në PZHK për realizimin e synimeve, zhvillimi programit për punësim social është realizuar tërësisht. Po ashtu publikimi i buletinit ka ndikuar në ngritjen e vetëdijësisë të popullatës njëkohësisht edhe informimin e tyre. Mirëpo, realizmi i pjesërishëm i trajnimeve ndikon në ngecje të zhvillimit social dhe ngadalësimin e procesit të uljes së papunësisë.

Ngritja e shkollave profesionale në fushën e bujqësisë është një ndër projektet me rëndësi të veçantë për zhvillim social dhe ndikim në zhvillim ekonomik. Mos zbatimimi i këtij projekti ndikon drejtëpërdrejtë në ngecje të zhvillimit social.

**B: ZHVILLIMI EKONOMIK** - Si katalizatorë për zhvillim ekonomik në komunën e Junikut është bujqësia. Konstatim i përgjithshëm është që brenda këtyre viteve për të cilën bëhet vlerësimi i PZHK nuk ka pasur ndonjë shpërthim në zhvillimin ekonomik, mirëpo është shpresëdhënëse që ende ka veprime për të zbatuar si: themelimi drejtorisë së bujqësisë, vetëdijësimi i popullatës për kultivimin e tokës bujqësore që do të ndikonte pozitivisht në zhvillim ekonomik por njëkohësisht edhe në ruajtje të tokës bujqësore.

Juniku ka potenciale për zhvillimin e turizmit. Promovimi i Gjeravices si maja më e lartë me 2656 metra ka ndikuar në rritjen e numrit të vizitorëve në Junik. Sa i përket organizimit të trajnimeve dhe përkrahjes së projekteve që gjenerojnë të ardhura, këto veprime që kanë ndikim në zhvillim ekonomik, janë të realizuara pjesërisht dhe janë të pamjaftueshme.

Gjatë hartimit të Hartës zonale është me rëndësi të përfshihen veprimet që do të stimulojnë bizneset e vogla në pjesën e vendbanimeve si p.sh. përmirësimi i akomodimit të turistëve etj. Moszbatimimi i veprimeve të parashikuara në plan ka ndikim direkt në ngecje të zhvillimit ekonomik që rezulton edhe me shpërngulje të papunësisë.

**C: INFRASTRUKTURA FIZIKE, TRANSPORTI DHE SHËRBIMET** - transporti dhe shërbimet publike janë më të shprehura në zonën 3 dhe 4 por në përgjithësi mund të themi se një sërë aktivitetesh janë zbatuar. Përmirësimi i infrastruktures rrugore është i dukshëm dhe kjo rezulton me lehtësimin e qarkullimit të automjeteve dhe shmangjen nga bllokimi i trafikut por njëkohësisht edhe mbrojtjen e mejdisit nga pluhuri i cili ka qënë i pranishëm para asfaltimit të rrugëve. Mirëpo, nga analiza që i është bërë PZHK-së vërehet se shumica e veprimeve të propozuara për këtë zonë janë

veprime afatgjata, ndërsa disa veprime të cilat propozohen të realizohen në vazhdimësi veq kanë filluar me realizimin e tyre. Mos themelimi i ndërrmarjes për menaxhim të mbeturina në kuadër të komunës së Junikut ka efekt negative. Me zbatimin e këtij veprimi komuna do të kishte mundësi të ngritë numrin e të punësuarve dhe në këtë mënyrë të ulë shkallën e papunësisë por njëkohësisht edhe të ngritë buxhetin vetanak.

**E: MJEDISI, RESURSET NATYRORE DHE ZONAT E RREZIKUARA NGA NDOTJA, DEGRADIMI DHE FATKEQËSITË PUBLIKE** - Edhe pse janë realizuar disa veprime në zonën bjeshkë dhe pyje ende kemi një sërë aktivitete për të realizuar. Por vlen të theksohet se pas shpalljes së bjeshkëve të Nemuna si park nacional të gjitha veprimet mbeten nën kompetenca të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Është me rëndësi të theksohet se komuna e Junikut brenda këtyre viteve (2011-2013) ka realizuar projekte të ndryshme që ndërlidhen me fushën e mjedisit dhe mbrojtjen e saj por ende ka hapësirë për të arritur shkallën e kënaqshme. Përkrahja e projekteve të mjedisit, ngritja e vetëdijes së popullatës, dukuritë që konsiderohen me rrezik mjedisor (termetet, rrëshqitja e dheut, zjarret, prerja e pakontrolluar e drunjëve etj) ende janë sfidë për komunë. Mos zbatimi i këtyre veprimeve ka efekt negativ dhe shpeshherë mund të rezultojë me dëme që kanë rezultate katastrofale. Vlen të përmendet se prerja e drunjëve në mënyrë të pakontrolluar mund të shpie deri te shpyllëzimi.

**F: TRASHËGIMIA KULTURORE** - Në PZHK është potencuar se aset tjetër i rëndësishëm për zhvillim ekonomik dhe ulje të papunësisë është trashëgimia kulturore që posedon Juniku. Konstatim i përgjithshëm është që komuna të vazhdojë të jep prioritet veprimeve të trashëgimisë kulturore dhe të bëjë promovimin e vazhdueshëm të trashëgimisë kulturore. Vlen të theksohet se gjatë këtyre viteve komuna ka arritur të gjejë forma të partneritetit publiko-privat dhe njëkohësisht të gjejë donacione të jashtme për restaurimin e kullave. Zbatimi i veprimeve të tilla ka rezultuar me mbrojtje të trashëgimisë kulturore. Me dhënjen e funksioneve si p.sh. muze, bibliotekë, qendër regjionale të turizmit, bujtinë përveq mbrojtjes së objektit arrihet njëkohësisht promovimi i vlerave të kulturës që pasqyrojnë traditën shumëvjeqare të popullit.

Nëse veprimet e parashikuara të trashëgimisë kulturore nuk finalizohen dhe nuk përfshihen rekomandimet e këtij raporti gjatë të hartimit të Hartes Zonale atëherë kjo do të rezultojë në zhdukjen e vlerave por në mënyrë indirekte do të ndikojë edhe në ngecje të zhvillimit ekonomik.


**D: SHFRYTËZIMI I TOKËS, VENDBANIMET DHE BANIMI PUBLIKE** - Gjatë periudhës 2011-2013 trajtimi vendbanimeve dhe vendbanimeve joformale nuk është bërë në mënyrë shumë të kënaqshme. Por edhe ndërtimi i hapësirave të reja të banimit nuk është arritur të bëhet. Mos realizimi i këtyre veprimeve do të ndikojë në rritjen e ndërtimeve pa leje të pakontrolluara. Si rekomandim i përgjithshëm është hartimi i planeve detale apo veglave tjera që do të kontrollojnë ndërtimet dhe njëkohësisht të legalizojnë ndërtimet pa leje. Në këtë mënyrë komuna do të ketë mundësi të grumbullojë më tepër mjete financiare dhe të ngrisë buxhetin vetanak.

**G: KAPACITETET NJERËZORE DHE ORGANIZATIVE NË FUSHËN E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR** - Në komunën e Junikut kapacitetet njerëzore që nga viti 2011 janë në ngritje e sipër. Ngritja e shkollave për bujqësi, sikurse që është theksuar në PZHK është i rëndësishë së vecantë për arsye se në këtë mënyrë popullata do të mirret me tepër me bujqësi dhe njëkohësisht do të mbrohen edhe tokat bujqësore.

Në PZHK është parashikuar edhe trajnimi i planereve në fushën e planifikimit. Ky veprimi duhet të konsiderohet si një ndër veprimet me prioritet të lartë për arsye se të gjitha zhvillimet në komunë rrjedhin prej planeve zhvillimore. Nëse kapacitetet e stafit janë të pamjaftueshme për monitorimin e planeve dhe identifikimin e problemeve të ndryshme që rrjedhin nga plani atëherë kjo mund të shpie deri tek zhvillimet e pakontrolluara në komunë me efekte negative që ndonjëherë edhe mund të jenë të papermirësueshme.


Në vijim është ilustruar në harta implementimi i projekteve gjatë viteve 2011-2013 në zonën urbane dhe në tërë territorin e komunës së Junikut.

Harta 4.1 Implementimi në Zonen Urbane







Burimi: MuSPP3-Grupi Working Group Municipality of Junik-UN-Habitat ,2014


Harta 4.2 Implementimi në territorin e Komunës së Junikut



Burimi: MuSPP3-Grupi Working Group Municipality of Junik-UN-Habitat ,2014

-  Projektet që janë zbatuar
-  Projektet pjesërisht të zbatuara
-  Projektet që nuk janë zbatuar
-  Projektet të zbatuara por që nuk janë në PZHK të Junikut

Harta 4.3 Implementimi i PZH-së gjatë viteve 2011-2013 dhe efektet





## V. KONKLuzionet dhe Rekomandimet

Numri i përgjithshëm i projekteve të përfshira në PZHK e Junikut (2011-2023) është 121 në total. Gjatë viteve 2011-2013 janë parashikuar të realizohen 76 projekte (62.80 %). Prej 76 (62.80 %) projekteve të parashikuara 32 (26.4 %) projekte janë zbatuar tërësisht, 23 (19.00 %) projekte nuk janë zbatuar dhe 21 (17.35 %) projekte janë zbatuar pjesërisht. Duhet të theksohet se Komuna ka filluar të zbatojë para afatit 23 projekte tjera. Këto projekte kanë qenë të planifikuara të zbatohen pas vitit 2014. Prej 23 projekteve 13 janë zbatuar tërësisht ndërsa 10 pjesërisht. Nëse analizojmë numrin total të projekteve në PZHK dhe numrin e projekteve që janë planifikuar të zbatohen brenda periudhës 2-3 vjeqare në raport me vitin 2011 – 2023 për të cilën periudhë është hartuar PZHK-ja, atëherë mund të konstatojmë se ekziston një disbalancë dhe gati është e pamundur që brenda një periudhe 2-3 vjeqare të realizohen të gjitha projektet. Por është inkurajuese se një pjesë e projekteve që është në zbatim pas finalizimit do të kenë efektet e tyre.

Pasi që papunësia është sfidë në Komunën e Junikut krahas përparësive që popullsia është e re dhe e aftë për punë rekomandim i tjetër i rëndësishëm është përfshirja/zbatimi e veprimeve të ndryshme që do të ndikojnë në zhvillimin social si edhe implementimi i programit për punësim social. Duhet të jepet prioritet më i madhë veprimeve që përhshijnë përmirësimin e hapësirave/objekteve publike ku zhvillohen aktivitetet sociale.

Në zonën e tretë vlerat e trashëgimisë kulturore janë mundësi e mirë për zhvillimin e ardhshëm ekonomik të bazuar kryesisht në turizëm kulturor. Për këtë arsye gjatë hartimit të hartës zonale apo planeve tjera të përfshihen më tepër veprime që do të stimulojnë bizneset e vogla në pjesën e vendbanimeve si dhe të bëhet përmirësimi i akomodimit për turistë etj. Këto veprime janë katalizatorë që do të stimulojnë zhvillimin ekonomik në këtë zonë.

Rekomandim tjetër është edhe hartimi i planeve detale për zona të caktuara që merrë për bazë zhvillimin e turizmit dhe jep orjentimet e duhura zonës së tretë.

Rekomandim tjetër është kompletimi i rrjetit të kanalizimit në pjesën e vendbanimeve dhe të jepet prioritet i lartë. Themelimi i ndërmarrjes për menaxhim të mbeturinave në kuadër të komunës do të kishte pasur një rëndësi të vecantë sepse në këtë mënyre komuna do të ketë mundësi të punësojë punëtorë dhe njëkohësisht kjo do të ndikojë në uljen e shkallës së papunësisë. Pos kësaj, kjo do të ndikonte në mënyrë indirekte në mbrojtjen e mjedisit. Rekomandohet që gjatë hartimit të hartës zonale të përfshihet në kuadër të veprimeve dhe njëkohësisht të jepet prioritet i lartë.

Rekomandim tjetër shumë me rëndësi është edhe projekti për trajtimin e ujërave të zeza që duhet të përhshihet në mesin e projekteve me prioritet shumë të lartë.

Trajtimin të vendbanimeve dhe vendbanimeve joformale duhet të jepet prioritet gjatë hartimit të hartës zonale. Po ashtu duke pasur parasysh rëndësinë e hapësirave të reja të banimit dhe ndërtimit në zonën urbane, komuna e

Junikut duhet të mundësoje zbatim të plotësishëm për afat sa më të shkurtër. Duhet të konsiderohet dhe jipet prioritet përmirësimit të rrugëve nëpër vendbanime dhe shërbimet e transportit publik që do të zvogëlojë përdorimin e veturave dhe përmirësoje qarkullimin e këmbësorëve. Edhe më tutje çështja e humbjes së tokës bujqësore duhet të konsiderohet si sfidë duke përfshirë ndërtimet e ndryshme, ndotjen etj. Si rekomandim tjetër i rëndësishëm është promovimi i vlerave natyrore pra tokës bujqësore si një resurs natyror dhe fuqizohet shfrytëzimi racional i tij .

Ofrimi i shërbimeve publike me cilësore ende mbetet prioritet dhe rekomandimi është që të konsiderohet gjatë hartimit të hartës zonale duke përfshirë edhe shfrytëzimin e energjisë alternative.

Rekomandimi i përgjithshëm është që në të ardhmen gjatë hartimit të planeve, projekteve të vendbanimeve dhe banimit të jepet prioritet më i lartë. Gjatë hartimit të Hartës zonale duhet të jepet prioritet shumë i lartë zbatimit të projektit "Hartimi i rregullores dhe programit për rregullimin e ndërtimeve pa leje" për arsye se në këtë mënyrë Komuna do të ketë mundësi të ngritë buxhetin vetanak por paralelisht edhe të zvogëlojë numrin e ndërtimeve pa leje.

Dukuritë që konsiderohen me rrezik mjedisor si: tërmetet, vërshimet, rrëshqitja e dheut, zjarret si dhe aktivitetet e pakontrolluara të njerëzve (prerja e pakontrolluar e pyjeve, mbeturinat, shkarkimi i ujërave të zeza në lumenj etj) dhe veprimet që parashihen për uljen e rrezikut nga këto dukuri duhet të jenë të prioritet shumë të lartë. Rekomandim tjetër është që kohëzgjatja e finalizimit të këtyre veprimeve duhet të jetë i shkurtër.

Pasi që PZHK mbështet në parimin e promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm, duhet të referohemi në shfrytëzimin racional të resurseve dhe të gjitha veprimet të jenë konform këtij parimi. Fuqizimi i bashkëpunimit ndërkomunal për mbrojtje të mjedisit të mbahet edhe më tutje gjatë hartimit të planeve dhe të jetë i prioritetit të lartë.

Trashëgimisë kulturore duhet të jepet theks të veçantë pasi që konsiderohet si katalizatore për zhvillimin e komunës së Junikut. Ngritja e kapaciteteve humane dhe qeveritare është primare për mbrojtjen dhe promovim të vazhdueshëm të trashëgimisë kulturore. Si rekomandim i përgjithshëm është që ky veprim të përfshihet vazhdimisht në plane. Si veprim tjetër shumë me rëndësi që ka nevojë për prioritet më të madhë është edhe lista e inventarizimit dhe digjitalizimi i të dhënave si dhe marketingu i trashëgimisë.

Ndërtimit të shkollës profesionale në fushën e bujqësisë duhet të përfshihet në listën e projekteve dhe njëkohësisht të jepet prioritet i lartë. Mos zbatueshmëria e këtij projekti do të reflektohet në ngecje të zhvillimit ekonomik dhe paralelisht do të ketë ndikim në ritje të papunësisë.

Duke u bazuar në faktin që zhvillimi ekonomik i Junikut bazohet kryesisht në bujqësi atëherë duhet të jepet më tepër rëndësi në zbatimin e tërësishëm të projekteve pjesërisht të zbatuara. Po ashtu promovimit të produkteve bujqësore dhe blegtoriale duhet të jepet prioritet shumë i lartë dhe projektet e cekura më lartë që nuk kanë arritur

të zbatohen brenda periudhes 2011-2013 të përfshihen më tutje gjatë hartimit të planeve dhe të jepet prioritet shumë i lartë. Mos zbatueshmëria e këtyre projekteve ka ndikim direkt në zhvillim ekonomik. Nëse kemi ngecje ekonomike në Junik atëherë kjo do të reflektohet në ngritje të papunësisë që do të shpie edhe në migrimin e popullsisë në vende tjera. Themelimi i drejtorisë së bujqësisë në kuadër të strukturës organizative të komunës, është i rëndësishëm së vecante në këtë mënyrë do të krijohej lidhja mes fermerëve dhe nivelit qendror në zbatimin e politikave bujqësore. Edhe më tutje vetëdijesimi i popullatës për kultivimin e tokës bujqësore duhet të ketë prioritet dhe të përfshihet në hartimin e planeve të mëtutjeshme.

Rekomandim gjeneral për këtë fushë tematike është që projektet që janë pjesërisht të zbatuara të finalizohen. Ndërsa ato të prioritetit të mesëm të përfshihen gjatë hartimit të Hartës Zonale.

Konkludim i përgjithshëm është se të gjitha zhvillimet në Komunën e Junikut bazohen në PZHK. Rekomandim i përgjithshëm është që komuna duhet të azhurnojë planin e vperimit në pajtim me të dhënat e dalura nga ky raport dhe për të përmbushur obligimet ligjore duhet të fillojë me Hartë Zonale të Komunës dhe të konsiderojë rekomandimet të dalura nga ky raport.

Duke u bazuar në faktin që zhvillimi ekonomik i Junikut bazohet kryesisht në bujqësi përkundër veprimeve të zbatuara si konkludimi i përgjithshëm është që nuk kemi ndonjë zhvillim të madhë të bujqësisë. Ngecja në zhvillim ekonomik shpie në rritje të shkallës së papunësisë që në mënyrë direkte ndikon edhe në migrimin e popullatës.

Është shumë më rëndësi që në të ardhmen komuna të konsiderojë numrin e popullsisë nga rregjistrimet e fundit në Kosovë, rekomandimet nga Parku Nacional i Bjeshkëve të Nemuna dhe nga Vlerësimi I Ndikimit. Të gjitha këto rekomandohet të përfshihen në Harta zonale dhe të konsiderohen veprimet që kanë për qëllim mbrojtjen e lumit, pyjeve, tokës bujqësore, ujit nëntokësor, llojet e bimeve e sidomos atyre farmaceutike etj.

Konkludim tjetër i rëndësishëm është se brenda këtyre viteve edhe pse janë realizuar një sërë projekte, mund të vërehet se në zonën urbane pak janë trajtuar hapësirat publike apo imazhi dhe pejsazhi i qytetit të Junikut. Rekomandohet që të hartohen plane detale, apo vegla tjera që do të kontrollojnë ndërtimet dhe të pengojnë ndërtimet e pakontrolluara.

## VI. SHTOJCA

### 6.1 ZBATIMIT I PROJEKTEVE SIPAS ZONAVE NË HAPËSIRË

#### 6.1.1 ZONA 1

##### **BJESHKA - ZHVILLIMI I TURIZMIT SI REZULTAT I POTENCIALEVE TË TRASHHEGIMISE NATYRORE**

*Përshkrimi i zonës sipas Planit Zhvillimor të Komunës*

Kjo zonë përfshin një sipërfaqe të madhe (rreth 4.000 Ha) dhe shtrihet në lartësi mbidetare mbi 2500 m. Është zonë e kryesisht e zhveshur ndaj edhe nuk ka mundësi për kultivimin e kulturave vegjetative. Ajo që e bën karakteristike këtë zonë është pika më e lartë Gjeravica me një lartësi mbidetare 2656 m . Duke marrë parasysh këto karakteristika, kjo zonë mund të shfrytëzohet për kullosa dhe zhvillimin e turizmit malor (sidomos alpinizmit).

Sipërfaqet e mëdha me pyje, livadhe e kullosa paraqesin faktorë favorizues të zhvillimit të blegtorisë përcjellur me mundësinë e zhvillimit të industrisë ushqimore. Juniku ka pasur traditë në zhvillimin e sektorit të blegtorisë ndaj dhe kjo traditë duhet të fuqizohet edhe më tutje. Në anën tjetër, edhe pse ajo po zhvillohet në masë të vogël sidomos pas luftës, bujqësia mbetet një sektor i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik nëse rritet interesimi për kultivimin e kulturave intensive dhe industriale sidomos kultivimi në sera dhe krahas kësaj fuqizimi i sektorit privat për t'i kushtuar rëndësi më të madhe zhvillimit të agro-biznesit Turizmi i bazuar në natyrë dhe ai kulturor është i dukshëm dhe paraqitet si një ndër potencialet më të fuqishme për zhvillim ekonomik, por, që vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet edhe zhvillimit të infrastrukturës turistike dhe të sektorëve tjerë përcjellës të tij si: hotelerisë, artizanateve, kulturës, sportit e rekreacionit etj. Pasuritë ujore, sidomos lumi Erenik paraqet një potencial të madh në të ardhmen në zhvillimin e sektorit të energjisë së ripërtërishme/alternative.

Sipas planit pengesë është qasja deri në Bjeshkë e cila është e vështirë, mungesa e infrastrukturës së nevojshme për shfrytëzim racional qoftë për nevoja të vendësve ose atyre për vizita turistike. Pra ofrimi i kushteve më të mira për lëvizshmërinë e banorëve (shtigjet e këmbësorëve, trotualet, sinjalizimet etj) por edhe turistëve janë poashtu një sfidë e veçantë për tu ballafaquar. Meqë turizmi shihet si një potencial i ardhshëm për zhvillim, një rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet edhe infrastrukturës përcjellëse që e ndihmon zhvillimin e këtij sektori (rregullimi i vijave të ecjes deri në zonat turistike, vendkampingjet, etj).

**Bjeshkët e Junikut** janë pjesë përbërëse e Alpeve Shqiptare (duke iu referuar raportit të MMPH mbi gjendjen në natyrë, Bjeshkët e Nemuna janë propozuar për mbrojtje<sup>1</sup> në nivel kombëtar).

Në vitin 2003, MMPH, respektivisht Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit të Kosovës në Prishtinë punoi "Studimin mbi arsyeshmërinë e shpalljes së territorit të Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional" pasuar me përgatitjen edhe të projekt-ligjit për të. Kjo zonë shpallet Park Nacional. Sipërfaqja e propozuar për këtë park është afro 500 km<sup>2</sup>. Gjendja momentale në këtë zonë, nuk është e lakmueshme për shkak të prezencës së dukurive negative (prerja e pyjeve, ndërtimi i objekteve të banimit dhe atyre hoteliere etj) të cilat po dëmtojnë peisazhin dhe biodiversitetin përreth, ndaj dhe shpallja e kësaj zone Park Nacional, do ti kontribuonte ndalimit të këtyre dukurive negative.

Në zonën e Junikut ka lloje relikte të faunës dhe florës përfshirë edhe lloje endemike barishtore autoktone me vlera të larta shkencore dhe farmaceutike. Për shkak të faunës së zhvilluar e sidomos të shumë llojeve të shpendëve prezent, Alpet Shqiptare në kuadër të cilave përfshihen edhe Bjeshkët e Junikut, janë evidentuar në listat ndërkombëtare si IBA (Important Bird Area)<sup>2</sup> dhe Librin e Kuq të Evropës.

Çështjet që duhet të adresohen janë:

- Rrugët në pyje dhe zona malore janë të shumta. Shumica e tyre janë të paklasifikuara dhe mund të përdoren vetëm me kuaj dhe traktorë apo ndoshta nëpërmjet automjeteve 4x4 për terren. Asnjë prej tyre nuk është e përshtatshme për biçikleta të zakonshme, vetura, kamionë ose autobusë, duke përfshirë rrugën "kryesore" drejt luginës së Erenikut dhe më tej në Liqejtë e Gjeravicës. Për këtë arsye ka vështirësi të qasjes në zonën pyjore dhe malore për çfarëdo veprimi rutinor lidhur me zhvillimin e turizmit apo menaxhimit të pasurive pyjore.
- Lëvizja ndërmjet lagjeve të vendbanimeve kryesore në Junik realizohet kryesisht me anë të mjeteve jo-motorike, ecje dhe çiklizëm. Në shumë raste, infrastruktura ekzistuese nuk iu është përshtatur kërkesave në rritje për lëvizje të shpejtë dhe të sigurtë, si dhe motorizimit në rritje.
- Nuk ekzistojnë shtigje të përshtatura për ecje, (alpinizëm), çiklizëm, kalërim dhe skijim nordik.

Analiza e pronësisë: Kryesisht shoqërore

## **A: ZHVILLIMI SOCIAL DHE INFRASTRUKTURA SOCIALE**

Duke u mbështetur në synimet të cilat I ka pas PZHK, si:

- AQ1 - përmirësimi i gjendjes sociale ekonomike

---

<sup>1</sup> Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, Zonë e Mbrojtur e natyrës është zona e shpallur me qëllim të mbrojtjes dhe përkujdesjes së biodiversitetit, peisazheve, karakteristikave natyrore dhe trashëgimisë kulturore dhe për ofrimin e menaxhimit efektiv përmes mjeteve juridike dhe mjeteve tjera.

<sup>2</sup> MMPH (2003), studim mbi arsyeshmërinë e shpalljes së territorit të Bjeshkëve të Nemuna Park nacional

- AQ2 - Përmirësimi I kualitetit të jetës përmes ngritjes së hapësirave dhe objekteve publike,
- AQ3 – Zhvillimi I shoqërisë informative, të organizuar dhe pjesëmarrëse në vendimmarrje.

Veprimet e propozuara për arritjen e këtyre synimeve janë të shprehur në zonën urbane.

Duke ju referuar strategjive A1, A2 dhe A3, shohim se veprimet që duhet të ndërmerren I përkasin zonës urbane në të shumtën e rasteve, mirëpo ka edhe veprime të cilat në mënyrë indirekte e prekin zonën bjeshkë dhe zhvillimin e saj si:

- Projekte që promovojnë aktivitete kulturore sportive,
- Përkrahja e projekteve të OJQ-ve të cilat promovojnë vlera,
- Ngritja e kapaciteteve njerëzore në fushën e bujqësisë, turizmit dhe fushave që ndërlidhen me to.

### **B: ZHVILLIMI EKONOMIK**

Sipas PZHK synimet e zhvillimit të ardhshëm ekonomik të Junikut janë që të ketë ngritje në të gjithë sektorët ekonomik, por në veqanti mbështetet në turizëm, bujqësi duke përfshirë blegtorinë, pylltarinë dhe sektorin e energjisë alternative.

- BQ1 – zhvillim I qëndrueshëm ekonomik në të gjitha sferat e veqmas në Bujqësi turizëm dhe energji alternative,
- BQ2 – Rritja e bashkëpunimit ndërkomunal dhe ndërkufitarë.

Ndërsa veprimet gjegjësisht strategjitë për realizimin e synimeve dhe qëllimeve janë këto:

- Zhvillim I qëndrueshëm ekonomik në të gjitha fushat
- Bashkëpunimi ndërkomunal dhe ndërkufitarë.
- Shënimi I ditëve të gjeravicës kombinuar me projektin për sinjalizim turistik.
- Bashkëpunimi me AZHR në hartimin e projekteve të karakterit ndërkomunal – ndërkufitarë.
- Bashkëpunimi me komunat fqinje në projektet me interes të përbashkët.

Veprimet e lartëshënuara si të parapara nga PZHK janë kryesisht veprime që mund të zhvillohen për gjatë gjithë territorit të komunës e kësisoji edhe në zonën 1 ( Bjeshkë).

Disa nga veprimet e planifikuara veq janë në realizim pasi që nuk janë projekte që mund të zhvillohen vetëm për një periudhë kohore por janë aktivitete që parashihen të zhvillohen në vazhdimësi.

Sigurisht që këto veprime janë relevante për periudhën për të cilën hartohet raporti, ndërsa për periudhat më afatgjata ka akoma projekte e veprime të propozuara të cilat mbetet të shihet më tutje.

### **C: INFRASTRUKTURA FIZIKE, TRANSPORTI DHE SHËRBIMET PUBLIKE**

Infrastruktura fizike , transporti dhe shërbimet publike për zonën 1 janë më pak të shprehura.

Infrastruktura rrugore është në gjendje të dobët dhe shpesh e pakalueshme sidomos në periudhat me reshje të mëdha atmosferike.

Transporti publik për këtë zone nuk ekziston, dhe edhe shërbimet publike nuk janë shumë relevante për këtë fushë.

***Rrjeti infrastrukturor:** krijimin e hapjeve të reja, në mënyrë që të krijohen lehtësi në qarkullim të automjeteve dhe banorëve e vizitorëve, PZHK ka përcaktuar këto qëllime:*

CO1: Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës fizike sipas kushteve teknike bashkëkohore në tërë territorin e Komunës dhe më gjerë

CO2: Përmirësimi gjegjësisht shtrirja e transportit publik urban dhe ndërrurban me shërbime dhe elemente përcjellëse si dhe infrastrukturës adekuate për këmbësorë

***Shërbimet publike:** Në sferën e shërbimeve publike, shtrirja e këtyre shërbimeve në zonat ku mungon, paraqet sfidë, ndaj dhe qëllimet dhe objektivat e PZHK-së në lidhje me këtë aspekt janë:*

CO3: Përmirësimi dhe shtrirja e shërbimeve publike konform standardeve bashkëkohore në gjithë territorin e Komunës së Junikut

Për ti arritur këto synime PZHK parasheh strategjitë gjegjësisht veprimet të cilat propozohen të ndërmerren e ato janë:

## **PËRMIRËSIMI DHE ZGJERIMI I INFRASTRUKTURËS FIZIKE SIPAS KUSHTEVE TEKNIKE BASHKËKOHORE NË TËRË TERRITORIN E KOMUNËS DHE MË GJERË**

Përmirësimi i infrastrukturës rrugore përmes hapjes së rrugës unazore (tranzitit); Ofrimi i qasjes më të lehtë në Bjeshkët e Junikut, krijimi i lidhjes rrugore me dy shtetet fqinje janë objektivat e përcaktuara me PZHK dhe për arritjen e tyre strategjia propozon këto projektet/veprime:

- Ndërtimi i rrugës që shkon deri në Bjeshkë
- Krijimi i infrastrukturës së këmbësorëve për zhvillimin e sportit dhe rekreacionit jashtë zonës urbane (rregullimi i shtigjeve për ecje-ngjitje në bjeshkë, çiklizëm, rregullimin e shtigjeve për kalërim, rregullimi i shtigjeve për zhvillimin e sporteve ekstreme p.sh ngjitjes me motorë, shenjëzimi i pikave vrojtuese/soditëse dhe atyre me vlera kulturore) etj.

Mirëpo, nga analiza që I është bërë PZHK-së vërehet se shumica e veprimeve të propozuara për këtë zonë janë veprime afatgjata, ndërsa disa veprime të cilat propozohen të realizohen në vazhdimësi veq kanë filluar me realizimin e tyre si psh.shenjëzimi I shtigjeve të ecjes nëpër disa pjesë të kësaj zone.

## **D: SHFRYTËZIMI I TOKËS, VENDBANIMET DHE BANIMI**

Sipas PZHK-së, kjo fushë tematike më shumë është e shprehur për zonat 3 (zona e banimit) dhe 4 (fushë), pasi që tokat e kategorisë I-IV përgjithësisht shtrihen në këto zona, e poashtu edhe karakteri I zgjerimit të ndërtimit dhe

banimit është e shprehur në këto zona, kurse ndërtimet në zonën bjeshkë janë më shumë të karakterit të tëbanave (shtëpive verore) me material rrethanor, ndërtime këto të karakterit sezonal të shfrytëzimit.

Sipas PZHK-së nuk ka ndonjë veprim të propozuar për këtë zonë për fushën tematike për të cilën flasim.

## **E: MJEDISI, RESURSET NATYRORE DHE ZONAT E RREZIKUARA NGA NDOTJA, DEGRADIMI DHE FATKEQËSITË**

Gjendja e mjedisit në komunën e Junikut, mund të thuhet në përgjithësi se është relativisht e mirë. Aktivitete ndotëse industriale nuk ka e sidomos zona për të cilën flasim.

Kjo zone pra Bjeshkë është e pasur me peisazhe, burime natyrore dhe biodiversitet.

Pozita gjeografike, relievi, malet e larta, grykat, lumenjtë, peisazhet dhe kullosat së bashku me florën dhe faunën që zhvillohet në to, paraqesin një bazë të mirë të zhvillimit të trashëgimisë natyrore për t'i mundësuar kështu komunës së Junikut të bëhet një vend atraktiv për t'u vizituar dhe zhvilluar në të ardhmen. Vet qyteza e Junikut konsiderohet si një "qytezë e mbështjellë nga natyra" për shkak se natyra depërton në pjesë të konsiderueshme të saj.

Peisazhet hidrografike, ato kodrinore apo malore (Gjeravica, Maja e Gusanit, Maja e Rupës, Rrasa e Zogut, Jedova,) paraqesin vlera të rëndësishme natyrore dhe potencial për zhvillimin e turizmit. Në zonën e Junikut ka lloje relikte të faunës dhe florës përfshirë edhe lloje endemike barishtore autoktone me vlera të larta shkencore dhe farmaceutike. Për shkak të faunës së zhvilluar e sidomos të shumë llojeve të shpendëve prezent, Alpet Shqiptare në kuadër të cilave përfshihen edhe Bjeshkët e Junikut, janë evidentuar në listat ndërkombëtare si IBA (Important Bird Area)<sup>3</sup> dhe Librin e Kuq të Evropës. Shpatijet e përshtatshme për zhvillimin e sporteve dimërore dhe rekreative (ngjitje në bjeshkë), Liqejtë e bukura të Gjeravicës, burime e rrjedha lumejsh, gryka, pyje të larta dhe një faunë e shumëllojshme e bëjnë Junikun zonë atraktive me mundësi të zhvillimit të turizmit gjatë gjithë vitit. Sipas konceptit të punuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë<sup>4</sup>, lokalitetet me potencial të rëndësishëm të zhvillimit të turizmit bazuar në trashëgiminë natyrore janë:

- Lokaliteti i Gradinës paraqet potencial për sport e rekreacion (sport ujor, peshkim, gjueti),
- Lokaliteti Jedova- potencial për zhvillimin e turizmit alpin, turizmit rekreativo-kurativ, gjueti etj.
- Lokaliteti Gropa e Erenikut dhe Rrasa e Zogut për shkak të pozitës gjeografike paraqet një lokalitet me vlera të larta turistike si dhe mundësi për zhvillimin e bashkëpunimit ndërkufitar mes Kosovës, Shqipërisë dhe Malit të Zi. Gjithashtu ka mundësi për zhvillimin e ekoturizmit. Sipas raportit të lartpërmendur, dhe duke iu referuar

<sup>3</sup> MMPH (2003), studim mbi arsyeshmërinë e shpalljes së territorit të Bjeshkëve të Nemuna Park nacional

<sup>4</sup> MTI, "Projektet e Produktit Turistik në Rajonin Turistik të Bjeshkëve të Nemuna (Alpet Shqiptare), dhjetor 2008



studimeve ndërkombëtare të bëra në vitet '70, në rajonin turistik të Junikut Rrasa e Zogut paraqet një vend me mundësi për ngritjen e një qendre turistike.

- Lokaliteti Burimi i Erenikut dhe Liqejtë e Gjeravicës ofrojnë mundësi për zhvillimin e ekoturizmit, turizmit alpin për shkak të Majës së Gjeravicës si dhe aplikimin e gjuetisë dhe bashkëpunim ndërkufitar.

Duke u mbështetur në fakte të lartpërmendura PZHK-ja e Junikut përfshirë këto qëllime:

EQ2: Ruajtja e peisazheve dhe biodiversitetit

EQ3: Fuqizimi i bashkëpunimit ndërkomunal dhe ndërshtetëror

Ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe organizative për fushën e mjedisit, Hartimi i planit lokal të veprimit për mbrojtjen e mjedisit, Aktivitete pastrimi dhe sensibilizim opinionit për mbrojtjen e mjedisit, Përkrahja e projekteve të OJQ mjedisore, Hartimi i planit për mbrojtjen e biodiversitetit për komunën e Junikut, Përkrahja e projekteve të Shoqatave (shoqata e gjuetarëve) dhe OJQ për mbrojtjen e florës dhe faunës (projektet për pasurimin e faunës sidomos drenit të cilit i kanoset rreziku nga zhdukja dhe ushqimi i tyre gjatë dimrit); shtimit të fondit të egërsirave, mbrojtja nga sëmundjet, Ndërmarrja e fushatave për sensibilizim opinionit për mbrojtjen e florës dhe faunës dhe monitorimi i shfrytëzimit të boronicës dhe bimëve mjekuese, Inicimi i bashkëpunimit ndërkomunal dhe ndërshtetëror për politikën ambientale (Projekti Parku i Paqes) dhe veprimet e përbashkëta për mbrojtjen nga fatkeqësitë.

Disa nga këto veprime mjedisore janë realizuar pjesërisht pasi që janë veprime që propozohen të ndërmerren në vazhdimësi.

#### **F: TRASHËGIMIA KULTURORE**

Sikurse që është theksuar në PZHK që Juniku ka vlera të veçanta të trashëgimisë kulturore sidomos ato arkitekturale (kullat, shtëpite, mullinj), arkeologjike dhe asaj shpirtërore, mirëpo përveq asaj arkeologjike, vlerat tjera të trashëgimisë shtrihen kryesisht në Zonën urbane dhe nuk kemi ndonjë veprim që do të ishte relevant për zonën bjeshkë.

#### **G: KAPACITETET NJERËZORE DHE ORGANIZATIVE NË FUSHËN E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR**

Strategjitë dhe veprimet e parapara me PZHK I dedikohen kryesisht zonës urbane, ndërsa sa I përket zonës Bjeshkë nuk parashihet ndonjë veprim.

### **6.1.2 ZONA 2**

#### **Zona pyje**

*Përshkrimi i zonës sipas Planit Zhvillimor të Komunës*

Zona e pyjeve përfshin një territor përafërsisht prej 3400 Ha. Në kuadër të kësaj zone ndodhen dy fshatrat Jasiq dhe Gjocaj që aktualisht janë gati të depopulluara. Për shkak të karakteristikave morfologjike, kjo zonë shfrytëzohet për zhvillimin e aktiviteteve blegtorale, pemëtarisë, bujqësisë dhe poashtu paraqet potencial për zhvillimin e turizmit e sidomos atij rural.

Analiza e pronësisë: Pronësia në këtë zonë është e përzier (shoqërore dhe private)

Potenciali pyjor në nivel të Kosovës është 41.8% me rreth 455000 Ha<sup>5</sup>. Në komunën e Junikut, Pyjet (respektivisht kulturat pyjore ku përfshihen edhe masat drunore në tokat bujqësore), zënë sipërfaqe prej 3197 Ha që i bie rreth 41% të territorit të komunës së Junikut<sup>6</sup>. Në pronësi private janë rreth 22% e pyjeve. Rreth 50% e pyjeve janë të reja rreth moshës 30 vjeçare me lloje të drurit të ahut, gështenjës, dushkut dhe verriit. Llojet më të përhapura janë: Ahu (dominon në 79 % të sipërfaqes pyjore), halorët : Pisha e Zezë, Hormoqi, Bredhi, Arneni (rreth 20 % të sipërfaqes në pyjet publike). Gështenja, Dushku e Verri janë kryesisht në pronësi private, ndërsa Mështekna si dhe gjethor dhe halor të tjerë kryesisht në pronësi publike dhe në sipërfaqe të vogla.

Për të gjitha llojet ekzistojnë kushte optimale për rritje të drurëve të një kualiteti të lartë<sup>7</sup>. Rritje vjetore e masës drurore në gjithë sipërfaqen pyjore është ~5.07 m<sup>3</sup>/Ha<sup>8</sup>. Potenciali i zhvillimit të pylltarisë në Junik në favor të zhvillimit të industrisë së drurit dhe përpunimit final ende nuk është hulumtuar. Aktualisht ato shfrytëzohen për prodhimin e drurit për djegie, meqë, tregu dhe organizimi i mirëfilltë që një sasi e konsiderueshme nga pyjet e ahut të shfrytëzohet për nevoja të industrisë së drurit mungon.

Sektori i pyjeve private është dobët i organizuar dhe me institucionalizim të kufizuar që shpie tek një Sektor i pylltarisë që nuk siguron kuadër dhe shërbime të nevojshme optimale për sektorin privat. Shumica e pyjeve kanë menaxhim të pa qëndrueshëm dhe prerjet ilegale mbesin problem serioz. Në sektorin privat të pyjeve kjo ndodh për shkak që korniza ligjore e sektorit privat dhe e decentralizimit të menaxhimit të pyjeve nuk është e rregulluar plotësisht. Ekziston një nivel i ulët i përfshirjes së akterëve vendor, siç janë komunat dhe komunitetet në sektorin e pylltarisë duke rezultuar në rregullim të limituar të menaxhimit të pyjeve lidhur me nevojat e këtyre akterëve dhe duke i kufizuar mundësitë për zhvillim ekonomik. Hapat e parë në zhvillimin e pylltarisë private janë hedhur me themelimin e Shoqatës së Pronarëve të Pyjeve me përkrahjen e projektit të SNV –SIDA, për forcimin e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve. Zhvillimi i sektorit privat dhe decentralizimi pyjeve i ep një mundësi të mirë zhvillimit ekonomik rural. Sidomos në zonat e largëta, sektori i pylltarisë është një ndër sektorët që siguron të ardhura dhe mundësi punësimi. Aktualisht, për shkak të kushteve të kufizuara, pyjet nuk përdoren dhe nuk

---

<sup>5</sup> Sipas të dhënave nga Projekt Plani Hapësinor i Kosovës, 2009

<sup>6</sup> Të dhënat sipas Elaboratit Kadastral Komunal nga regjistrimi i vitit 1983. Situata në terren mund të jetë e ndryshueshme

<sup>7</sup> Të dhëna nga SNV 2011

<sup>8</sup> Sipas të dhënave nga Agjencia Kosovare e Pyjeve (2009)

menaxhohen në mënyrë të duhur (ka degradim dhe shterrim resursesh pyjore). Kushtet e duhura (institucionale, sociale dhe ekonomike) mund ta ndryshojnë këtë, ku pyjet private dhe të decentralizuara janë duke kontribuar në ekonominë rurale dhe duke i ruajtur shërbimet pyjore në dobi të shoqërisë duke kontribuar në mirëqenien sociale dhe ekonomike.

Depopullimi i vendbanimeve Jasiq dhe Gjocaj paraqet një sfidë, zgjidhja e së cilës është mjaft komplekse, meqë ngërthen në vete gërshetimin e shumë aspekteve të zhvillimit si: social, ekonomik, infrastrukturor dhe atë të sigurisë (për shkak të prezencës së minave). Ofrimi i kushteve më të mira për jetesë, banorëve në këto vendbanime në mënyrë që t'u mundësohet kthimi i tyre në shtëpi (pronat e veta do të duhej të jenë një ndër synimet dhe prioritetet strategjike të Komunës).

Në pyjet e Junikut dukuria e prerjes së drunjve është prezente sidomos e shprehur tek pyjet në sektorin publik (në lokacionet Stanishtë e Goqit, Zharrë, Gradinë). Pasojat nga kjo, përveç humbjes së masës drurore, paraqiten edhe në çrregullimin e ekosistemit, prishjen e peisazhit, paraqitjen e erozionit në këto zona etj. Një brengë tjetër që ka të bëjë me shkatërrimin e pyjeve është edhe prezenca e insekteve të rrezikshme dhe epidemisë që ka prekur drurin e gështenjës (40% e gështenjave janë të sulmuara nga i ashtuquajtimi kancer i gështenjës). Shpresohet se tani me kalimin e kompetencave në menaxhimin e pyjeve tek institucionet lokale situata në terren të menaxhohet më mirë dhe të pengohet degradimi i pyjeve.

Zonat erozive ku intensiteti është më i madh e të cilat duhet të kenë trajtim të veçantë janë ato zona ku ka prerje të pyjeve ilegale të drunjve (sipas informatave të komunës prerja ilegale nuk bëhet nga banorët e komunës së Junikut por nga banorët e komunave të tjera përreth që kufizohen me Junikun). Rreziku nga erozioni është prezent edhe në vendbanimet Jasiq dhe Gjocaj ku ka rrëshqitje të dheut (informata këto nga banorët se nuk ka studime të bëra për këtë zonë) si dhe në sipërfaqet afër brigjeve të lumejve. Një shkaktar i erozionit në tokat e zhveshura dhe të pjerrëta janë reshjet e vjeshtës nënkuptohet kur ato janë të furishme. Zonat erozive ku intensiteti është më i madh duhet të kenë trajtim të veçantë. Parandalimi i aktiviteteve erozive kërkon marrjen e masave konkrete si: ndalimi i prerjes së pyjeve, zëvendësimi i drunjve të prerë me mbjelljen e fidaneve të reja, ndalimi i shfrytëzimit të materialeve inerte që shkaktojnë erozion, etj.

Juniku ka potencial të pa përdorur në krijimin e energjisë alternative dhe burimeve të tjera natyrore, të cilat mund të ndryshojnë për të mirë dhe minimizojnë efektet nga ndryshimet klimatike. Ministria e Energjisë dhe Minierave (MEM) ka hartuar një studim parafizibiliteti mbi identifikimin e burimeve ujore për hidrocentrale të vogla në Kosovë (2006), ku tre prej këtyre hidrocentraleve gjenden në komunën e Junikut.<sup>9</sup>

---

<sup>9</sup> Shoqata Shqiptare për energji të qëndrueshme dhe mjedis , Studimi i parafizibilitetit mbi identifikimin e burimeve ujore për hidrocentrale të vogla, MEM, Maj 2006, Kosovë

- Lokaliteti Gjocaj dhe Jasiq janë lokalitete të cilat ofrojnë mundësi për zhvillimin e turizmit rural dhe ekoturizmit, zhvillimin e gjuetisë dhe turizëm konferencial.
- Lokaliteti Zharra për shkak të karakteristikave gjeo-morfologjike, paraqet potencial për zhvillimin e turizmit rural dhe ekoturizmit, turizmit konferencial, si dhe mundësi për ngritjen e një Qendre rekreative-rehabilituese

Potenciali i shfrytëzimit të drunjve në favor edhe të zhvillimit të industrisë së drurit dhe përpunimit final nuk është hulumtuar ende. Aktualisht ky potencial shfrytëzohet për nevoja të ngrohjes. Korniza e zhvillimit hapësinor, në zhvillimin e kësaj fushe ekonomike, fokusin e ka në menaxhimin e këtij resursi nga Komuna dhe ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe organizative për menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve, pyllëzim dhe ripyllëzim të zonave të zhveshura si dhe hulumtimin për zhvillimin e industrisë së drurit dhe përpunimin final. Për të arritur këto duhet të aplikohen praktikrat që përfshijnë shumë palë në interes në modalitetet e shumë llojshme të menaxhimit të pyjeve si dhe të aplikohet menaxhimi i sektorit privat dhe decentralizimi i përgjegjësi që kanë të bëjnë me pyjet.

Çështjet që duhet të adresohen janë:

- Rrugët në pyje dhe zona malore janë të shumta. Shumica e tyre janë të paklasifikuara dhe mund të përdoren vetëm me kuaj dhe traktorë apo ndoshta nëpërmjet automjeteve 4x4 për terren. Asnjë prej tyre nuk është e përshtatshme për biçikleta të zakonshme, vetura, kamionë ose autobusë, duke përfshirë rrugën "kryesore" drejt luginës së Erenikut dhe më tej në Liqejtë e Gjeravicës. Për këtë arsye ka vështirësi të qasjes në zonën pyjore dhe malore për çfarëdo veprimi rutinor lidhur me zhvillimin e turizmit apo menaxhimit të pasurive pyjore.

- 

#### **A: ZHVILLIMI SOCIAL DHE INFRASTRUKTURA SOCIALE**

Duke u mbështetur në synimet të cilat I ka pas PZHK, si:

- AQ1 - përmirësimi I gjendjes sociale ekonomike
- AQ2 - Përmirësimi I kualitetit të jetës përmes ngritjes së hapësirave dhe objekteve publike,
- AQ3 – Zhvillimi I shoqërisë informative, të organizuar dhe pjesëmarrëse në vendimmarrje.

Synimet të lartpërmendura më shumë I referohen zonës urbane pasi që edhe koncentrimi dhe shtrirja e popullsisë është në këtë zone, ndërsa në zonën pyje në të cilën shtrihen edhe vendbanimet Gjocaj e Jasiq nuk janë shumë të shprehura pasi që edhe ashtu këto fshatra janë të depopulluara.

Poashtu edhe veprimet për arritjen e synimeve janë më shumë relevante për zonën urbane.

## **B: ZHVILLIMI EKONOMIK**

Sipas PZHK synimet e zhvillimit të ardhshëm ekonomik të Junikut janë që të ketë ngritje në të gjithë sektorët ekonomik, por në veqanti mbështetet në turizëm, bujqësi duke përfshirë blegtorinë, pylltarinë dhe sektorin e energjisë alternative.

- BQ1 – zhvillim I qëndrueshëm ekonomik në të gjitha sferat e veqmas në Bujqësi turizëm dhe energji alternative,
- BQ2 – Rritja e bashkëpunimit ndërkomunal dhe ndërkufitarë.

Ndërsa veprimet gjegjësisht strategjitë për realizimin e synimeve dhe qëllimeve janë këto:

- Zhvillim I qëndrueshëm ekonomik në të gjitha fushat
- Bashkëpunimi ndërkomunal dhe ndërkufitarë.
- Shënimi I ditëve të gjeravicës kombinuar me projektin për sinjalizim turistik.
- Bashkëpunimi me AZHR në hartimin e projekteve të karakterit ndërkomunal – ndërkufitarë.
- Bashkëpunimi me komunat fqinje në projektet me interes të përbashkët.

Veprimet e lartëshënuara si të parapara nga PZHK janë kryesisht veprime që mund të zhvillohen për gjatë gjithë territorit të komunës e kësajsoji edhe në zonën 2 ( pyje).

Disa nga veprimet e planifikuara veq janë në realizim pasi që nuk janë projekte që mund të zhvillohen vetëm për një periudhë kohore por janë aktivitete që parashihen të zhvillohen në vazhdimësi.

Projekti për A11 – projekti për punësim sezonal është projekt që është realizuar në këtë zone.

Sigurisht që këto veprime janë relevante për periudhën për të cilën hartohet raporti, ndërsa për periudhat më afatgjata ka akoma projekte e veprime të propozuara të cilat mbetet të shihet më tutje.

## **C: INFRASTRUKTURA FIZIKE, TRANSPORTI DHE SHËRBIMET PUBLIKE**

Infrastruktura fizike , transporti dhe shërbimet publike për zonën 2 janë më pak të shprehura.

Infrastruktura rrugore është në gjendje të dobët dhe shpesh e pakalueshme sidomos në periudhat me reshje të mëdha atmosferike.

CQ1: Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës fizike sipas kushteve teknike bashkëkohore në tërë territorin e Komunës dhe më gjerë

CQ2: Përmirësimi gjegjësisht shtrirja e transportit publik urban dhe ndërrurban me shërbime dhe elemente përcjellëse si dhe infrastrukturës adekuate për këmbësorë

CQ3: Përmirësimi dhe shtrirja e shërbimeve publike konform standardeve bashkëkohore në gjithë territorin e Komunës së Junikut

Për ti arritur këto synime Pzhk parasheh strategjitë gjegjësisht veprimet të cilat propozohen të ndërmerren.

- Ndërtimi i rrugës që shkon deri në Bjeshkë
- Krijimi i infrastrukturës së këmbësorëve për zhvillimin e sportit dhe rekreacionit jashtë zonës urbane (rregullimi i shtigjeve për ecje-ngjitje në bjeshkë, çiklizëm, rregullimin e shtigjeve për kalërim, rregullimi i shtigjeve për zhvillimin e sporteve ekstreme p.sh ngjitjes me motorë, shenjzimi i pikave vrojtuese/soditëse dhe atyre me vlera kulturore) etj.

Mirëpo, nga analiza që I është bërë PZHK-së vërehet se shumica e veprimeve të propozuara për këtë zonë janë veprime afatgjata, ndërsa disa veprime të cilat propozohen të realizohen në vazhdimësi veq kan filluar me realizimin e tyre si psh.

C14 Ndërtimi I rrugës që qon në bjeshkë, projekt ky që e përshkon këtë zone. Por ka edhe projekte të realizuara e që nuk janë të propozuara nga PZHK si : Hapja e rrugës Gjocaj Jasiq.

#### **D: SHFRYTËZIMI I TOKËS, VENDBANIMET DHE BANIMI**

Sipas PZHK-së, kjo fushë tematike më shumë është e shprehur tek zonat 3 (zona e banimit) dhe 4 (fushë), pasi që tokat e kategorisë I-IV përgjithësisht shtrihen në këto zona, e poashtu edhe karakteri I zgjerimit të ndërtimit dhe banimit është e shprehur në këto zona. Ndërtimet në zonën pyje nuk ka, përjashtim bëjnë dy fshatrat mirëpo edhe atje ndërtimet dhe rindërtimet janë kryesisht mbi bazamentet e vjetra.

Sipas PZHK-së nuk ka ndonjë veprim të propozuar për këtë zonë për fushën tematike për të cilën flasim.

#### **E: MJEDISI, RESURSET NATYRORE DHE ZONAT E RREZIKUARA NGA NDOTJA, DEGRADIMI DHE FATKEQËSITË**

Synimet që janë të perfshira në PZHK janë:

**EQ2: Ruajtja e peisazheve dhe biodiversitetit**

**EQ3: Fuqizimi i bashkëpunimit ndërkomunal dhe ndërshtetëror**

Ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe organizative për fushën e mjedisit, Hartimi i planit lokal të veprimit për mbrojtjen e mjedisit, Aktivitete pastrimi dhe sensibilizim opinioni për mbrojtjen e mjedisit, Përkrahja e projekteve të OJQ mjedisore, Hartimi i planit për mbrojtjen e biodiversitetit për komunën e Junikut, Përkrahja e projekteve të Shoqatave (shoqata e gjuetarëve) dhe OJQ për mbrojtjen e florës dhe faunës (projektet për pasurimin e faunës sidomos drenit të cilit i kanoset rreziku nga zhdukja dhe ushqimi i tyre gjatë dimrit); shtimit të fondit të egërsirave, mbrojtja nga sëmundjet, Ndërmarrja e fushatave për sensibilizim opinioni për mbrojtjen e florës dhe faunës dhe monitorimi i shfrytëzimit të boronicës dhe bimëve mjekuese, Inicimi i bashkëpunimit ndërkomunal dhe ndërshtetëror për politikën ambientale (Projekti Parku i Paqes) dhe veprimet e përbashkëta për mbrojtjen nga fatkeqësitë.

Disa nga këto veprime mjedisore janë realizuar pjesërisht pasi që janë veprime që propozohen të ndërmerren në vazhdimësi.

Ka edhe projekte të cilat janë realizuar si ai I fushatës së ndërgjegjësimit për rrezik nga minat.

#### **F: TRASHËGIMIA KULTURORE**

Sikurse që është theksuar në PZHK që Juniku ka vlera të veçanta të trashëgimisë kulturore sidomos ato arkitekturale (kullat, shtëpite, mullinjtë), arkeologjike dhe asaj shpirtërore, mirëpo përveq asaj arkeologjike, vlerat tjera të trashëgimisë shtrihen kryesisht në Zonën urbane, andaj edhe ky dokument nuk parasheh ndonjë veprim që do të ishte relevant për zonën.

#### **G: KAPACITETET NJERËZORE DHE ORGANIZATIVE NË FUSHËN E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR**

Strategjitë dhe veprimet e parapara me PZHK I dedikohen kryesisht zonës urbane, ndërsa sa I përket zonës pyje nuk parashihet ndonjë veprim.

### **6.1.3 ZONA 3**

#### **Vendbanimet, zhvillimi I aktiviteteve ekonomike dhe potencialet e trashëgimisë kulturore**

*Përshkrimi i zonës sipas Planit Zhvillimor të Komunës*

Në bazë të analizave të bëra në PZHK, deri në 2023 pritet që në Junik të ketë rreth 6600 banorë (pra pa diasporën), respektivisht rreth 8 700 banorë me diasporën (llogaritur me të dhënat nga anketimi për PZHK-në). Ky Plan për periudhën që hartohet nuk propozon zgjerim të zonës urbane, pra zona urbane mbetet në kufijtë e përcaktuar me PZHU. Ndërtimet në kuadër të **zonës ekzistuese** urbane - ku ka mundësi dendësimi në hapësirat e zbrazëta (sipas rekomandimeve të PZHU-së dhe PRrU “Qendra”. Kjo zonë veç ka infrastrukturë ekzistuese dhe qasje në shërbimet publike. Ndersa, **Zona e re** e ndërtimit jashtë zonës urbane janë dy sosh: Zona e re e ndërtimit **në funksion të banimit** në vendbanimet Jasiq dhe Gjocaj - e cila mund të akomodojë një pjesë të konsiderueshme të njësive të banimit. Zona të reja të ndërtimeve **në funksion të zhvillimit të turizmit dhe rekrejimit**

Kjo do të thotë se zonat e vendbanimit në 15 vitet e ardhshme duhet të pranojnë edhe rreth 1200 banorë rezident, respektivisht 3270 banorë përfshirë diasporën. Korniza e zhvillimit hapësinor e Junikut mundëson shfrytëzim racional të hapësirës, zvogëlon koston e infrastrukturës fizike dhe mundëson shfrytëzimin e infrastrukturës sociale ekzistuese që është në parametrat e pranueshëm. Trendet e zhvillimit janë duke treguar tendenca të shtrirjes së banimit në zonën me tokë bujqësore. Kjo dukuri duhet penguar. Për këtë arsye korniza e zhvillimit hapësinor të Junikut propozon mbrojtjen e tokës bujqësore nga ndërtimet dhe propozon zona të reja ndërtimi në fshatrat Jasiq dhe Gjocaj të cilat i parasheh të zhvillohen si fshatra turistike. Rivitalizimi i fshatrave Jasiq dhe Gjocaj në njërin

anë, lidhet ngushtë me kthimin e familjeve respektivisht me trajtimin e vendbanimit joformal Lagja “Agim Ramadani” por me parakushtin e krijimit të kushteve për kthim meqë në këto dy fshatra ka ende prezencë të minave. Gjithashtu ka nevojë edhe për investime në ofrimin e infrastrukturës fizike.

Sa përket institucioneve parashkollore Juniku ka nevojë për një çerdhe të fëmijëve. Ndersa, duke u bazuar në standardet për shkolla fillore, në Junik (për popullsinë e parashikuar) nuk ka nevojë për shkolla të reja fillore e as për ato të mesme. Rekomandohet krijimi i kushteve për shkolla profesionale në fushën e turizmit, artizanateve, gastronomisë, agrikulturës, energjisë alternative etj.

Trendet e reja të projektimit të këtyre hapësirave, tregojnë tendenca të shfrytëzimit maksimal dhe propozojnë ndërtimin e objekteve multifunkionale të cilat mund të shfrytëzohen për muze, shtëpi kulture, bibliotekë, ofrimin e qendrave rinore apo edhe atyre të komunitetit etj.

Juniku është Komunë e re dhe ende në konsolidim e sipër dhe ka nevojë për ngritjen e objekteve që adresojnë çështjet sociale përfshirë edhe ato për punësim. Analizat nga anketimi kanë treguar për prezencën e të moshuarve që jetojnë. Për plotësimin e nevojave të kësaj kategorie, është e nevojshme të sigurohet si fillim një zyre me personel i cili do të ofronte shërbim përkujdesjeje ndaj pleqve, kurse më vonë pas ndonjë analize detaje rreth kësaj problematike mund të paraqitet ndoshta edhe nevoja për ndërtimin e shtëpisë së pleqve.

Fusha e zhvillimit ekonomik në të gjitha sferat e në veçanti në turizëm dhe veprimtaritë përcjellëse të kësaj fushe, bujqësi përfshirë blegtorinë, pylltari dhe energji alternative si potenciale për zhvillim, është parë si prioriteti më i lartë për komunën e Junikut.

Juniku ka potencial të llojlojshëm për zhvillim të turizmit kulturor dhe atij natyror (rekreativ, kurativ, ekoturizmit, ndërkufitar, turizmit alpin, rural dhe atij konferencial). Zhvillimi i turizmit kulturor lidhet ngushtë me trashëgiminë arkitektonike (prezencën e kullave tradicionale) dhe atë shpirtërore (ruajtja e dokeve, zakoneve, riteve etj.

Sa i përket infrastruktures, fokusi kryesor në PZHK i është dhënë rrugës tranzit, hapjes së re të rrugës lokale “Te Udhë e Kuqe” e cila siguron dalje në rrugën regjionale si dhe infrastrukturës rrugore dhe asaj për këmbësorë për qasje në Bjeshkë.

Prioritet i lartë i jepet edhe përmirësimit dhe shtrirjes së shërbimeve publike në gjithë territorin e komunës së Junikut me theks të veçantë kompletimit të rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit, ndërtimit të kolektorit të ujërave të zeza dhe menaxhimit më të mirë të mbeturinave me marrjen e këtij shërbimi në kompetencë të komunës dhe themelimin e ndërmarrjes komunale për këtë shërbim.

#### **A: ZHVILLIMI SOCIAL DHE INFRASTRUKTURA SOCIALE**

Synimet që janë të përfshira në PZHK janë:

**AQ1: Përmirësimi i gjendjes sociale dhe ekonomike**



### **AQ3: Zhvillimi i shoqërisë informative të organizuar dhe pjesëmarrëse në vendimmarrje**

Duke u bazuar në veprimet që janë të paraparë në PZHK për realizimin e synimeve të lartëpërmendura, zhvillimi programit për punësim social është realizuar tërësisht. Poashtu publikimi I buletinit ka ndikim në ngritjen e vetëdijësit të popullatës njëkohësisht edhe informimin e tyre. Mirëpo, realizmi I pjesërishëm I trajnimeve ndikon në ngecje të zhvillimit social dhe ngadalësimin e procesit të uljes së papunësisë.

### **B: ZHVILLIMI EKONOMIK**

Synimet që janë të përfshira në PZHK janë:

**BQ1: zhvillim i qëndrueshëm ekonomik në të gjitha sferat por në veçanti bujqësi, turizëm, pylltari, energji alternative**

**BQ2: Rritja e bashkëpunimit ndërkomunal dhe ndërkufitar**

Sikurse është theksuar në PZHK Juniku nuk ka ekonomi të zhvilluar sa duhet. Sa I përket organizimit të trajnimeve dhe përkrahjes së projekteve që gjenerojnë të ardhura, këto veprime që kanë ndikim në zhvillim ekonomik, janë të realizuara pjesërisht dhe janë të pamjaftueshme. Më tepër zhvillim ekonomik parashihet në Zonen 4.

Synimet që janë të përfshira në PZHK janë:

**CQ1: Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës fizike sipas kushteve teknike bashkëkohore në tërë territorin e Komunës dhe më gjerë**

**CQ2: Përmirësimi gjegjësisht shtrirja e transportit publik urban dhe ndërrurban me shërbime dhe elemente përcjellëse si dhe infrastrukturës adekuate për këmbësorë**

**CQ3: Përmirësimi dhe shtrirja e shërbimeve publike konform standardeve bashkëkohore në gjithë territorin e Komunës së Junikut**

Juniku ka një mbulueshmëri me rrjetin rrugor relativisht të mirë, por e cila ka nevojë për t'u kompletuar dhe përmirësuar, si dhe krijimin e hapjeve të reja, në mënyrë që të krijohen lehtësi në qarkullim të automjeteve dhe banorëve e vizitorëve. Sa i përket realizimit të veprimeve për arritjen e synimeve të lartëpërmendura, ndërtimi i rrugëve në zonën urbane është zbatuar pjesërisht. Po ashtu ndërtimi i stacionit të autobusëve, punimi i planit të mobilitetit, rregullimi i infrastrukturës së këmbësorëve në zonën urbane dhe në zona të vendbanimeve tjera janë të realizuara pjesërisht. Ndërsa themelimi i ndërmarrjes për menaxhim të mbeturinave nuk është zbatuar ndërsa përderisa hartimi i planit për administrim të mbeturinave është zbatuar pjesërisht.

### **D: SHFRYTËZIMI I TOKËS, VENDBANIMET DHE BANIMI**

Synimet që janë të përfshira në PZHK janë:

**DQ1: Mbrojtja dhe shfrytëzim racional i tokës bujqësore**

## **DQ2: Trajtimi i vendbanimeve**

### **DQ3: Trajtimi i banimi dhe ndërtimeve**

Për realizmin e synimeve të lartpërmendura, trajtimi i hapësirave ekzistuese dhe atyre të reja të banimit dhe Ndërtimet e reja në tokë bujqësore, fragmentimi i parcelave në njërën anë dhe depopullimi i dy vendbanimeve me zhvendosjen e popullatës dhe uzurpimin e pronave të banimit në lagjen “Agim Ramadani” duke krijuar kështu vendbanim joformal paraqesin një aspekt sfidues për trajtim. Mirepo, për këtë periudë të vlerësimit të implementimit të PZHK’së nuk përfshihet zbatimi i trajtimit të vendbanimeve dhe vendbanimeve joformale. Duhet të potencohet se gjatë kësaj periode është zbatuar pjesërisht trajtimi i hapësirave të reja të banimit dhe ndërtimit në zonën urbane.

Sa i përket kësaj zone është arritur të hartohet plani rregullativ QENDRA, PRR Gacafer - Pepq, PRR për lagjen Bajraktar - Qok. Ndërsa projekti: Hartimi i rregullores dhe programit për rregullimin e ndërtimeve pa leje edhe pse është i rëndësishëm së lartë nuk është i zbatuar. Sa i përket fushës së vendbanimit dhe banimit mund të konkludohet që nuk është dhënë edhe ndonjë prioritet shumë i lartë nga ana e Komunës. Vlen të përmendet projekti "Programit dhe planit të veprimit për banim dhe ndërtim" i cili nuk është zbatuar dhe konsiderohet i prioritetit të ulët.

Synimet që janë të përfshira në PZHK janë:

**EQ1: Mbrojtja dhe zhvillim i qëndrueshëm mjedisor**

**EQ2: Mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera**

**EQ2: Ruajtja e peisazheve dhe biodiversitetit**

**EQ3: Fuqizimi i bashkëpunimit ndërkomunal dhe ndërshtetëror**

Për realizmin e synimeve të lartpërmendura për fushën mjedisit dhe mbrojtjes për zonën e tretë (sipas PZHK) mund të themi se një pjesë e veprimeve është zbatuar. Në këto veprime përfshihen: hartimi i planit lokal të veprimit për mbrojtjen e mjedisit dhe aktivitetet e pastrimit dhe sensibilizimit të opinionit për mbrojtjen e mjedisit.

Ndërsa për mbrojtjen nga vërshimet është dhënë prioritet rregullimit të shtratit të lumit Erenik dhe analizës së trajtimit të çështjes së përmytjeve në lagjen Tofaj dhe Prita e Katundit. Mirëpo, ende përkrahja e projekteve të OJO mjedisore, hartimi i planit për mbrojtje dhe shpëtim, fushata për vetëdijesimin e popullatës mbeten sfida për Komunën e Junikut.

Mirëpo, themelimi i ndërmarrjes për menaxhim të mbeturinave në kuadër të komunës nuk është themeluar edhe pse ka qenë i planifikuar të bëhet gjatë viteve 2012-2013.

## **F: TRASHËGIMIA KULTURORE**

Synimet që janë të përfshira në PZHK janë:

### **FQ1: Mbrojtja dhe funksionalizimi i trashëgimisë kulturore**

Sikurse që është theksuar në PZHK që Juniku ka vlera të vecanta të trashëgimisë kulturore sidomos ato arkitekturale (kullat, shtëpite, mullinj), arkeologjike dhe asaj shpirtërore. Sa i përket zbatimit të veprimeve që kontribuojnë në ruajtjen, zhvillimin dhe promovimin e këtyre vlerave mund të konkullojmë që brenda këtyre dy viteve nuk janë zbatuar edhe shumë veprime. Për realizmin e synimit të lartëpërmendur, nga të gjitha veprimet e parapara në PZHK është realizuar gjetja e formave të partneritetit publiko-privat për mundësi të konzervimit, ndërtimi i muzeut të qytetit, restaurimi, konservimi dhe vënia në funksion publik.

Mirëpo, veprime tjera të rëndësishme si ngritja e kapaciteteve humane dhe koordinimi me Qendrën Regjionale për Trashëgimi Kulturor në Pejë, bashkëpunimi dhe pjesëmarrja aktive e komunës në aktivitetet autoriteteve qendrore në hartimin e politikave për ruajtjen, menaxhimin dhe shtimin e fushave të konservuara arkitekturale nuk është arritur të realizohet brenda afatit të paraparë. Po ashtu dhënja e statusit nën mbrojtje të përhershme dhe të përkohshme nuk është arritur të realizohet dhe këto veprime mbesin ende sfida për komunën e Junikut.

### **G: KAPACITETET NJERËZORE DHE ORGANIZATIVE NË FUSHËN E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR**

Synimi që është përfshirë në PZHK është:

#### **GQ1: Konsolidimi i strukturave të Planifikimit Hapësinor në Komunë**

Për realizmin e synimit të lartëpërmendur, gjatë analizës së veprimeve të përcaktuara në PZHK sa i përket kapaciteteve njerëzore brenda këtyre 2 viteve është vërejtur se një pjesë e veprimeve nuk janë të zbatuara e në këtë grup përfshihen trajnimi i inspekteve. Mirëpo është inkurajuese se me pjesëmarrjen e stafit teknik në hartimin e projekteve në fushën e planifikimit hapësinor është arritur që të ngriten kapacitetet e tyre.

Emërimi i GIS zyrtarit nuk është realizuar, mirëpo janë trajnuar pesë zyrtarë në GIS. Por ende mbetet sfida për komunë që të realizojë aplikimin të lejeve në formë elektronike.

### **D: SHFRYTËZIMI I TOKËS, VENDBANIMET DHE BANIMI PUBLIKE**

Synimet që janë të përfshira në PZHK janë:

#### **DQ1: Mbrojtja dhe shfrytëzim racional i tokës bujqësore**

#### **DQ2: Trajtimi i vendbanimeve**

#### **DQ3: Trajtimi i banimit dhe ndërtimeve**

Synimet të lartëpërmendura më shumë i referohen zonës së katërt.

#### **6.1.4 ZONA 4**

#### **Bujqësia**

*Përshkrimi i zonës sipas Planit Zhvillimor të Komunës*

Bujqësia paraqet një veprimtari të rëndësishme dhe potencial zhvillimor në Junik por fatkeqësisht shënon kultivim të ulët të rendimenteve bujqësore. Konkurrenca joreale në treg, qasja e vështirë në tokat bujqësore, mos-organizimi i fermerëve, kreditë jo të favorshme, kapacitete të pamjaftueshme njerëzore në komunë në këtë fushë, mosinteresimi i të rinjëve për t'u marrë me këtë profesion etj., janë disa arsye të ngecjes së zhvillimit të bujqësisë. Koncepti i zhvillimit të ardhshëm hapësinor i komunës, e vendos mbrojtjen e tokës bujqësore dhe zhvillimin e bujqësisë si prioritet të larta të zhvillimit të ardhshëm.

Kultivimi i frutave: Kultivimi, grumbullimi i frutave me theks të veçantë atyre pyjore (gështenjat, boronicat) dhe plasimi i tyre në tregjet e jashtme si dhe bimëve më veti shëruese është një mundësi zhvillimi.

Agro-industria: Krahas ruajtjes së këtij resursi, korniza e zhvillimit hapësinor rëndësi i kushton edhe zhvillimit të agroindustrisë në lokacionin e përcaktuar si zonë për prodhimtari në PZHU si dhe tregut të gjelbërt gjithashtu. Fuqizimi i sektorit të bujqësisë në kuadër të komunës, ngritja e kapaciteteve organizative të fermerëve, fushata vetëdijesimi etj., janë disa aspekte tjera zhvillimore të bujqësisë.

Blegtoria: Nga fusha e blegtorisë, bletaria është parë si veprimtari më shpresëdhënëse dhe potencial për zhvillim pasuar me prodhimin e mjaltës. Zhvillimi i kësaj veprimtarie lidhet ngushtë me prodhimtarinë e pemëtarisë.

#### **A: ZHVILLIMI SOCIAL DHE INFRASTRUKTURA SOCIALE**

Synimet që janë të përfshira në PZHK janë:

**AQ1: Përmirësimi i gjendjes sociale dhe ekonomike**

**AQ2: Përmirësimi i kualitetit të jetës përmes ngritjes së hapësirave dhe objekteve publike**

**AQ3: Zhvillimi i shoqërisë informative të organizuar dhe pjesëmarrëse në vendimmarrje**

Për realizmin e synimeve të lartpërmendura për këtë zone, ngritja e shkollave profesionale në fushën e bujqësisë është një ndër projektet me rëndësi të vecantë për zhvillim social dhe ndikim në zhvillim ekonomik. Mos zbatimi i këtij projekti ndikon drejtëpërdrejtë në ngecje të zhvillimit social.

#### **B: ZHVILLIMI EKONOMIK**

Synimet që janë të përfshira në PZHK janë:

**BQ1: zhvillim i qëndrueshëm ekonomik në të gjitha sferat por në veçanti bujqësi, turizëm, pylltari, energji alternative**

**BQ2: Rritja e bashkëpunimit ndërkomunal dhe ndërkufitar**

Sikurse është përmendur edhe më parë zhvillimi ekonomik i Junikut bazohet kryesisht në bujqësi, blegëtori, pylltari dhe energji alternative. Për realizmin e synimeve të lartpërmendura janë paraparë një sërë projektesh dhe një numër i konsiderueshëm i tyre është zbatuar brenda periudhës për të cilën bëhet ky vlerësim. Vlen të përmenden

projektet e zbatuara: Hapja e trasesë me zhavor e rrugës së Turbisë, Trasimi/shtrimi me zhavor i rrugës Miroc Uleza, Asfaltimi i rrugës Shafrane- Hybe, Shtrimi me zhavor i rrugës të arave të Prita e Katundit që zgjedhin problemin e qasjes më të lehtë në toka bujqësore. Mirëpo zbatueshmëria e pjesërishme e projekteve: “Ngritja e pemishteve intensive”, “Qershiza-Boronica e Junikut”, “Ndërtimi i kanaleve primare të ujitjes”, “Bashkepunimi me komuna fqinje me intrese të përbashkët, me theks të vecantë në bujqësi” ka ndikim në ngecje të zhvillimit ekonomik.

Duhet të potencohen edhe projektet edhe pse janë të paraparë të zbatohen brenda viteve 2011-2013 por nuk janë të zbatuara, sikurse: “Hartimi i planit rregullës urban për zonën ekonomike duke u bazuar në zhvillim të bujqësisë dhe agro-biznes”, “Riparimi i pendave në Jaruha”, “Ngritja e tregut për shitjen e produkteve bujqësore-blegtorale përfshirë edhe aktivitetet e magazinimit të perpunimit sin je qëndër shpërndarëse”, “Zhvillimi i programit/aktiviteteve të marketingut Produktete Junikut”, “Themelimi i njësisë apo drejtorisë së bujqësisë në kuadër të strukturës organizative të komunës”.

### **C: INFRASTRUKTURA FIZIKE, TRANSPORTI DHE SHËRBIMET PUBLIKE**

Synimet që janë të përfshira në PZHK janë:

CQ1: Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës fizike sipas kushteve teknike bashkëkohore në tërë territorin e Komunës dhe më gjerë

CQ2: Përmirësimi gjegjësisht shtrirja e transportit publik urban dhe ndërrurban me shërbime dhe elemente përcjellëse si dhe infrastrukturës adekuate për këmbësorë

CQ3: Përmirësimi dhe shtrirja e shërbimeve publike konform standardeve bashkëkohore në gjithë territorin e Komunës së Junikut

Për realizimin e synimeve të lartpërmendura sa i përket infrastrukturës për zonën e katërt vlen të përmenden projektet e zbatuara: Hapja e trasesë me zhavor e rrugës së Turbisë, Trasimi/shtrimi me zhavor i rrugës Miroc Uleza, Asfaltimi i rrugës Shafrane- Hybe, Shtrimi me zhavor i rrugës të arave të Prita e Katundit.

Ndërsa projektet: Ndërtimi i segmentit rrugor ‘Udha e Kuqe’ (qasje në rrugë regionale), Asfaltimi i rrugës Junik-Nivokaz, Ndërtimi i rrugës që qon deri në Bjeshkë, Hartimi i programit për trajtimin e ujërave të zeza dhe atyre atmosferik janë pjesërisht të realizuara.

### **D: SHFRYTËZIMI I TOKËS, VENDBANIMET DHE BANIMI**

Synimet që janë të përfshira në PZHK janë:

DQ1: Mbrojtja dhe shfrytëzim racional i tokës bujqësore

DQ2: Trajtimi i vendbanimeve

DQ3: Trajtimi i banimit dhe ndërtimeve

Për realizimin e synimeve të lartpërmendura, në kuadër të zoneës së katërt përfshihet vetëm projekti: Krijimin e kadastrit (evidencës) së tokës bujqësore në GIS, i cili projekt është i zbatuar tërësisht. Nuk janë paraparë projekte tjera që do të klasifikoheshin në zonën e katërt, pra ato të bujqësisë.

#### **E: MJEDISI, RESURSET NATYRORE DHE ZONAT E RREZIKUARA NGA NDOTJA, DEGRADIMI DHE FATKEQËSITË**

Synimet që janë të përfshira në PZHK janë:

EQ1: Mbrojtja dhe zhvillim i qëndrueshëm mjedisor

EQ2: Mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera

EQ2: Ruajtja e peisazheve dhe biodiversitetit

EQ3: Fuqizimi i bashkëpunimit ndërkomunal dhe ndërshtetëror

Për fushën e lartpërmendur në kuadër të kësaj zone nuk përfshihen shumë projekte. Ndër projektet e zbatuara janë: Hartimi i planit lokal të veprimit për mbrojtjen e mjedisit dhe Analiza për trajtimin e çështjes së përmbytjeve në lagjen Tofaj dhe Prita e Katundit. Ndërsa, Ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe organizative për fushën e mjedisit dhe caktimi i zyrtarit për mjedis është zbatuar pjesërisht.

#### **F: TRASHËGIMIA KULTURORE**

Nuk janë paraparë projekte që do të klasifikoheshin në zoneën e katërt.

#### **G: KAPACITETET NJERËZORE DHE ORGANIZATIVE NË FUSHËN E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR**

Nuk janë paraparë projekte që do të klasifikoheshin në zonën e katërt.

